



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 09.08.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. *Diskutimi dhe vendimmarrja në lidhje me shpalljen e fillimit të procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, për sa i përket vendeve vakante si më poshtë:*

- *Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese , vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.*

- *Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese , vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi, në datën 28.08.2018.*

- *Vendi vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.*

2. *Relatimi për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidaturës dhe zhvillimi i intervistave, sipas ligjit, me kandidatët e lejuar për vendet vakante.*

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 7. Fatjona Memçaj | (anëtar) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plotë të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaroi të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

1. Diskutimi dhe vendimmarrja në lidhje me shpalljen e fillimit të procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, për sa i përket vendeve vakante si më poshtë:

- Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese , vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.

- Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese , vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi, në datën 28.08.2018.

- Vendi vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

2. Relatimi për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidaturës dhe zhvillimi i intervistave, sipas ligjit, me kandidatët e lejuar për vendet vakante.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës, fillimisht për diskutimin dhe vendimmarrjen për gjendjen në të cilën ndodhet procedura e verifikimit të kandidatëve për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

Ardian Dvorani, në cilësinë e anëtarit relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave për këtë vend vakant, shpjegon se deri më tani, nga 6 kandidatë që kanë shprehur interesin për kandidim dhe janë zhvilluar procedurat e verifikimit nuk ka më asnjë kandidat të lejuar. Dy kandidatë janë tërhequr prej kohësh nga kandidimi. Kandidati Vasil Bendo është ndaluar kandidimi, është zhvilluar edhe procedura e ankimimit në Gjykatën Administrative

të Apelit dhe në Gjykatën Administrative në Shkallë të Parë dhe ankimi i kandidatit është rrezuar. Në tre rastet e tjera është vendosur ndalimi i kandidimit, për kandidatët Fiona Papajorgji, Sinan Tafaj dhe Valbona Bala, të cilët janë njoftuar mbi vendimin dhe është konfirmuar marrja e vendimit prej tyre. Kushtetuta parashikon që organi i emërtesës e zgjedh anëtarin e ri të Gjykatës Kushtetuese ndërmjet 3 kandidatëve të renditur në vend më parë. Lidhur me këtë parashikim kushtetues, në vendimin normativ të KED nr.4/2019, në pikën 32, përcaktohet se kur gjatë zhvillimit të procedurave të verifikimit, për shkak të tërheqjes nga kandidimi apo të vendimeve të ndalimit të kandidimit, rezulton që numri i kandidatëve zbret në më pak se tre, njoftohet kryetari i Këshillit, thirret mbledhja dhe vendoset për mënyrën e procedimit të mëtejshëm. Sipas pikës 49, pas diskutimit të çështjes, Këshilli vendos njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për kandidaturë në atë pozicion vakant të Gjykatës Kushtetuese. Në të tilla rrethana, si relator i çështjes, propozoj të procedohet me pezullimin e procedurës së verifikimit dhe njoftimin e organit të emërtesës, Kuvendit për të vlerësuar rishpalljen e pozicionit vakant. Është organi i emërtesës i cili do ta vlerësojë situatën dhe do të mbajë qëndrimin e tij në kohën kur e çmon të përshtatshme. Gjithashtu, mbajmë parasysh se, me rregullat kalimtare që janë miratuar, procedurat e vlerësimit të kandidaturave fillojnë kur ka përfunduar procedura e verifikimit në tërësi për vakancat.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë për mënyrën e procedimit të mëtejshëm lidhur me këtë vend vakant dhe duke vlerësuar që në kushtet kur nuk ka më asnjë kandidat të mbetur në garë, nuk ka vend as edhe për të disponuar pezullim të procedurës së verifikimit të kandidaturave, por vetëm për njoftim të organit të emërtesës për të vlerësuar rishpalljen e vakancës.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se nuk ka ndonjë pyetje ose koment për të bërë.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se nuk kam komente për këtë rast, nuk kemi më asnjë kandidat.

Anëtarët e Këshillit unanimisht vendosin të njoftojnë subjektin që e ka vënë në lëvizje, Kuvendin, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për kandidaturë në këtë pozicion vakant të Gjykatës Kushtetuese.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, parashtron se vendi tjetër vakant në Gjykatën Kushtetuese për tu diskutuar është ai që ka dekretuar Presidenti i Republikës me dekretin nr.10723, datë 07.02.2018, për vakancën e parakohshme të krijuar pas mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj. Ka pasur 15 kandidatë dhe për shkak tërheqjeve apo ndalimit të kandidimit kanë mbetur vetëm dy kandidatë të lejuar, z.Besnik Muci dhe znj.Regleta Panajoti.

Eriol Roshi, në cilësinë e anëtarit relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave për këtë vend vakant, shpjegon se kanë mbetur vetëm dy kandidatë të

lejuar në këtë vakancë, ndërkohë që pritet se si do të shkojë procedura e mundshme e ankimit të kandidatit të fundit që mund ta ushtrojë këtë të drejtë në Gjykatën Administrative të Apelit.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë për mënyrën e procedimit të mëtejshëm lidhur me këtë vend vakant, në rrethanat kur kanë mbetur vetëm dy kandidatë të lejuar për kandidim për vendin vakant të shpallur me dekretin nr.10723, datë 07.02.2018 të Presidentit të Republikës, për një tjetër kandidat nuk është ezauruar ende e drejta e ankimit dhe shqyrtimi i mundshëm nga Gjykata Administrative e Apelit, si edhe duke pasur parasysh që Kushtetuta dhe ligji përcaktojnë kompetencën e organit të emërtesës të zgjedhë/emërojë gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese ndërmjet tre kandidatë të renditur më lart nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ndërkohë që nuk ka parashikime ligjore për mënyrëne procedimit nga KED nëse nuk ka apo nuk mbeten së paku tre kandidatë të lejuar për kandidim për vijmin me procedurat e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se unë përfaqësoj organin e emërtesës. Presidenti ka qenë i interesuar në vijimësi që të ketë sa më shpjet një Gjykate Kushtetuese funksionale dhe për këtë shkak, për ta rikujtuar edhe një herë në mënyrë kronologjike, në 31.01.2018 ish gjyqtari Besnik Imeraj ka dhënë dorëheqjen dhe është shprehur me vendim Gjykata Kushtetuese. Brenda ditës i është njoftuar organit të emërtesës. Brenda 7 diteve organi i emërtesës, Presidenti i Republikës, ka bërë publikimin. Në datën 27 shkurt është mbyllur faza e aplikimeve. Në datën 28 shkurt është njoftuar Këshilli i atëhershëm. Në mars është bërë mbledhja e parë, në datën 19. Ka vijuar me procesin e dorëzimit të dokumentave dhe ka mbaruar gjatë periudhës prill. Kanë aplikuar mbi 16 kandidatë, një ka dhënë dorëheqjen para se të fillonte verifikimi. Kanë ngelur 2 kandidatë, Besnik Muci dhe Regleta Panajoti, ndërsa Zhaklina Peto është e skualifikuar.

Me njoftimin, vendimmarrjen që do bëjë Këshilli sot dhe njoftimin e organit të emërtesës është një gjë e sigurt. Organi i emërtesës në rast se do të marrë njoftimin e Këshillit që do të pritet faza ankimmore, nuk do veprojë në mënyrë urgjente për të rihapur një vakancë brenda gushtit, Ne do të jemi shumë të kujdesshëm. Pas vendimit të marrë nga Këshilli pezullimi i këtij procesi çfarë efekti do të ketë? Pezullimi i kësaj vakance për të vijuar më tutje pas vendimit të Gjykatës Administrative? A ndikon kjo tek vakancet e tjera kur aplikantja është në të njëjtën listë?

Ne jemi shumë korrekt dhe ne harmoni me njoftimin që do të bëni. Nuk do të nxitojmë që të ngatërojmë procedurat gjyqësore me ato administrative. Logjika e ligjit është e njëjtë. Fakti që gjykata e apelit mund të jetë me pushime, nuk mund ta shqyrtojë për 7 ditë por për 17 ditë apo 27 ditë, ne do të jemi koherent dhe do të kërkojmë nga Këshilli që do të jetë edhe palë, të na njoftoni edhe shkresërisht që gjendja është e tillë. Ne në fund të ditës mirëpresim një listë me 3 kandidatë

sipas Kushtetutës që të zgjedhim, minimalisht me tre kandidatë nga të cilët të tërheqim atë që e meriton. Edhe po se tërheqem në 30 ditë pastaj do shpallet fituesi sipas ligjit.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtroon se lidhur me çështjen nëse duhet të njoftohet apo jo organi i emërtesës lidhur me këtë fakt, unë mendoj se organi i emërtesës duhet të vihet në dijeni qoftë edhe për shkaqet e transparencës, qoftë edhe për shkak të detyrimit ligjor dhe interesit që ka publiku për të ditur se në cilën pikë është ky proces. Organi i emërtesës do të ketë pastaj vendimmarrjet përkatëse në lidhje me rishpalljen apo jo eventualisht të procesit. Ajo që dua të sqaroj në rastin konkret ka më shumë të bëjë me faktin e pezullimit. Zyra e Avokatit të Popullit ka qenë e mendimit se përtej parashikimeve ligjore ne do tu japin të drejtë efektive ankimit të individëve apo qytetarëve. Pra kjo e drejtë e ankimit nuk shikohet si e drejtë strikte me parimet ligjore, por të jetë një e drejtë efektive dhe kjo ka qenë një nga gjërat që unë kam shprehur në mbledhje si një qëndrim të institucionit që përfaqësoj.

Në rastin konkret duke qenë se neni 238 parashikon shprehimisht se ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe verifikimit paraprak të kryer nga KED sipas nenit 240 të këtij ligji, duhet të kemi kujdes në llojin e vendimmarrjes. Në gjykimin tim Këshilli duhet të bëjë një interpretim të kësaj dispozite pak më të gjërë. Këtë qëndrim ta kemi në mënyrë të vazhdueshme. Nëse pezullimi i procedurës ka të bëjë me dërgimin e listës përfundimtare në organin e emërtesës apo ka të bëjë me veprime të tjera që janë të nevojshme për të shkuar në listën përfundimtare. Ky parashikim do të na ndalojë të marrim në intervistë kandidaten Regleta Panajoti? Ne e marrim në intervistë edhe për vakancën tjetër, por a do ta bëjë të qartë Këshilli që kjo intervistë i përket të dy vakancave? A do të duhet që, në një eventualitet sot apo mbas 6 muajsh kur të vinë kandidaturat e tjera, ta marrim prapë në intervistë kandidaten? Për të mënjeluar këto lloj problemesh apo pikëpyetje, ndoshta do të ishte rasti që të specifikohet nga ana e Këshillit në këtë vendimmarrje, pezullimi me çfarë lidhet? Do të vazhdojmë procesin e verifikimit për kandidatët e tjerë sa kohë që ka një veprim që do jetë intervista e kandidatës Regleta Panajoti? Pra pezullimi do të jetë i lidhur me dërgimin për në organin e emërtesës, duke qenë se gjithë veprimet e tjera janë kryer, intervista dhe vlerësimi na kanë ngelur për kandidatët? E them ngaqë kemi këtë parashikim ligjor dhe për shkak të tij do të na ndodhë edhe në vakanca të tjera. Në gjykimin tim, ky Këshill mund të kryejë veprime të tjera, nuk mund t'ia lidhim duart vetes në lidhje me këtë vakancë.

Të themi hipotetikusht, kandidati mendon se ajo nuk ishte intervista e vetme. Kërkon që të intervistohet prapë, pas 3 muajsh apo 6 muajsh. Mund të mos jetë më ky Këshill. Prandaj them që duhet ta sqarjomë këtë gjë sepse mundet që eventualisht edhe kjo procedurë e pezulluar, dashtë zoti të vazhdojë prapë me këtë Këshill, të kemi mundësi, shpresojmë që të krijohet Gjykata

Administrative, d.m.th teorikisht çfarë do të bëhet? Kandidati mund të thotë që dua prapë të intervistohem dhe kur bëhet intervista. Intervista bëhet në një procedurë vlerësimi, duke qenë se në rastin konkret nuk kemi kaluar në procedurë vlerësimi për atë vakancë, kandidati mund të thotë se nuk më është bërë kjo intervistë.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se Avokati i Popullit ka të drejtë në një farë mënyre, por i takon fazës tjetër. Por Këshilli duhet ta mendoj edhe këtë them unë. Janë kandidatë që janë të shpërndarë në të gjitha vakancat. Në një situatë ligjore ose nëse Gjykata e Apelit Administrativ do të zgjidhte që të shqyrtonte ankimin brenda afatit kur do ta administrojë, nëse ka një ankim, këto çështje mbarojnë shumë shpejtë dhe ndihmojnë edhe Këshillin. Të imagjinojmë pak një moment që duhet ta mendojë Këshilli, pra që ky ankim të shqyrtohet në kohë të zgjatur. Dy kandidatët e tjerë hipotikisht mund të zgjidhen nga organe të emërtesës. Pra lista ngel me më pak se tre kandidatë. Kandidatja fituese e gjyqësorit do të ngelet e pezulluar në Këshill deri sa të riçelë organi i emërtesës vakancën që të vijë kandidatura të reja që të plotësojnë treshen? Këshilli nuk mund të kalojë as në intervistim sepse kandidatët e tjerë mund të janë tërhequr dhe zgjedhur nga organet e tjera të emërtesës.

Anëtarët e Këshillit ridiskutojnë për mënyrën e procedimit të mëtejshëm lidhur me këtë vend vakant dhe, në thelb, mbajnë parasysh që për sa kohë nuk ka ndonjë dispozitë ligjore e cila, në pajtim me Kushtetutën, nuk përcakton shprehimisht ndryshe, në rastet kur pas procedurës së shpalljes së konkurrimit për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese shprehin interesin më pak se tre kandidatë është në vlerësimin e organit të emërtesës të vendosë për rishpalljen e konkurrimit ose përkatësisht për dërgimin e kandidatëve që kanë shprehur interesin për kandidim pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për të vijuar me procedurën e verifikimit dhe vlerësimin e të renditjes së tyre. Edhe në rastin kur gjatë apo në përfundim të procedurave të verifikimit rezulton se mbeten më pak se tre kandidatë në konkurrim për vendin vakant, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk ka autoritet të detyrojë organin e emërtesës që të përzgjedhë gjyqtarin e ri të Gjykatës Kushtetuese ndërmjet dy apo të vetmit kandidat të lejuar për kandidim. Edhe në këtë rast, është në vlerësimin e organit të emërtesës të vendosë ose jo për përzgjedhjen e gjyqtarit të ri ndërmjet atyre që u është lejuar kandidimi, ndonëse janë më pak se tre kandidatë, ose të vendosë rishpalljen e konkurrimit të atij vendi vakant.

Prandaj, në mënyrë unanime anëtarët e Këshillit vendosin që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi të njoftojë menjëherë organin e emërtesës, Presidentin e Republikës, për të vlerësuar mundësinë e rishpalljes së procedurës së konkurrimit për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj ose mundësinë e njoftimit Këshillit të Emërimeve në

Drejtësi që të vijojë me procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së dy kandidatëve të mbetur në konkurrim për këtë vend vakant. Ndërkohë, deri në ezaurimin e afateve procedurale, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi do të njoftojë menjëherë Institucionin e Presidentit të Republikës nëse ndonjëri nga kandidatët e ndaluar do të drejtohet me ankim Gjykatës Administrative të Apelit, si edhe për ecurinë e këtyre gjykimeve.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, parashtron se vendi tjetër vakant për tu diskutuar në lidhje me mënyrën e mëtejshme të procedimit është ai i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të cilin në përfundim të procedurave të verifikimit kanë mbetur katër kandidatë, ndërkohë që pika 4 e nenit 147 të Kushtetutës përcakton se Kuvendi përzgjedh nga një listë prej pesë kandidatësh që i dërgohen Këshilli.

Margarita Buhali, në cilësinë e anëtares relatores për ndjekjen e procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave për këtë vend vakant, shpjegon se është tashmë fakt që numri i kandidatëve ka zbritur nën pesë. Edhe më parë Këshilli ishte para situatës kur numri i kandidateve ishte vetëm tre 3 dhe u rivendos të rishpallej konkurrimi për këtë vend vakant. Aktualisht janë katër kandidatë të lejuar. Është i njëjti diskutim për sa i përket të drejtës së ankimit që mund të kenë kandidatët e ndaluar, sikurse janë edhe tek rasti i vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese të sapodiskutua të shpallur nga Presidenti i Republikës. Ndryshim i vetëm dhe që është specifik ka të bëjë se në këtë rast vendimmarrja për rishpallje ose jo të vendit vakant i përket KED-së dhe jo organit të emërtesës, Kuvendit. Tashmë kanë përfunduar procedurat e verifikimit për të gjithë kandidatët. Mbetet në vlerësimin e Këshillit nëse do të vendosim pezullim deri në pritje të disponimit të Gjykatës Administrative e Apelit sepse mjafton që për njërin nga kandidatët të disponohet ndryshe nga ajo gjykatë dhe ky vend vakant nuk ka pse të rishpallet sepse është i rindërtuar numri minimal prej pesë kandidatësh. Pra i vetmi ndryshim është se a do të vendosim pezullim të procedurave pa rishpallje ose e vlerësojmë ndryshe, Këshilli të presë për ankimet e mundshme dhe gjykimet përkatëse dhe më pas të vendosë KED njëkohësisht për pezullim procedurash dhe rishpallje.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe shtron pyetjet se kur fillojnë afatet e ankimit për kandidatët e ndaluar dhe nëse kemi dijeni a do të bëjnë ankim? Çfarë do të bëjmë sot me kandidatët e tjerë që do të duhet të intervistojmë, duke e lidhur me faktin e të drejtës së ankimit të kandidatëve të lejuar? Po sikur të mund të ndodhë që ndonjë kandidat të shkarkohet nga KPA? E bëra edhe këtë pyetje se ka pasur jo pak interesim nga gazetarët se si ka mundësi që KED do të vazhdojë me intervistat, për sa kohë që numri i kandidatëve ka rënë nën numrin e parashikuar nga ligji. Unë ju kam thënë që Këshilli nuk mund të marrë vendim për të vazhduar. Kemi qenë shumë të kujdesshëm dhe kjo vendimmarrje nuk është marrë. Por duke qenë se ishte shpallur kalendar i

intervistave, ka pasur një ndjesi lidhur me faktin nëse Këshilli kishte marrë apo nuk kishte marrë një vendim lidhur me këtë çështje. Unë gjithsesi isha e mendimit që do të diskutohet dhe vendoset në Këshill. Unë jam dakord me ju por dua të them edhe si është perceptimi në lidhje me këtë çështje dhe cili është qëndrimi i Këshillit.

Anëtarët e Këshillit, pas sqarimeve se janë kryer njoftimet për kandidatët e ndaluar, janë dy ndër kandidatët në afate për të ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit dhe se nuk mund të paragjykojnë vendimet që mund të marrë KPA, në vijim diskutojnë për mënyrën e procedimit të mëtejshëm lidhur me këtë vend vakant.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se diskutim i Avokates së Popullit është i drejtë. Ka një dallim në këtë proces sepse Këshilli është organ për të bërë shpallje dhe nuk është organ emërtese. Kuvendi është edhe rregullatori që ka caktuar me ligj numrin prej pesë kandidatësh. Kjo është situatë shqetësuese. Më shqetëson edhe mosprania e përfaqësuesve të Kuvendit, edhe komisionit të ligjeve edhe të kryetarit të Kuvendit. Kuvendi si organ emërtese do të shprehet në shtator. A e cenon besimin e publikut nëse Këshilli vazhdon me intervistat? Çfarë vlerë ka intervistimi nëse në fund nuk do të përcillet lista? Janë çështje shumë sensitive sepse do ti thuhet publikut që Këshilli e shpalli në mars në 2019 për të njëjtin shkak, sepse kishte tre kandidatë, pse kur u shtua një kandidat, u bënë katër e vazhdoi? Pastaj fillohet të merret me emrat e kandidatëve ku anatemohen pa fund edhe në media. Kuvendi duhet të vihet në dijeni. Mungesa e përfaqësueses të Kuvendit është shumë shqetësuese, duhet të jetë një përfaqësues i opozites dhe një mazhorancës në Këshill sepse këtë e parashikon ligji. Kanë kaluar 30 muaj sipas afatit kushtetues dhe jemi pa Inspektor të Lartë të Drejtësisë. Kjo duhet të jetë shqetësuese për Kuvendin. Për të mos u keqkuptuar, mungesa e përfaqësuesve të Kuvendit është shumë shqetësuese jo sepse ata nuk vijnë por sepse ata nuk janë të informuar për dinamikën e zhvillimeve në këtë proces.

Anëtarët e Këshillit, vijojnë diskutimin për mënyrën e procedimit të mëtejshëm lidhur me këtë vend vakant dhe në thelb shprehin qëndrimet se për shkak të numrit të kandidatëve nën minimumin që përckaton Kushtetuta vendimmarja për vakancën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka ngjashmëri me rastet e tilla të diskutuara për vakancat në Gjykatën Kushtetuese pavarësisht se pjesa e vendimit për rishpalljen e vakancës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk i përket orgnait të emërtesës – Kuvendit por vetë KED-së. Prandaj në kushtet kur nuk janë ezauruar afatet e ankimit për kandidatë të ndaluar të shtyhet vendimmarja deri në përfundim të këtyre afateve apo deri në dhënien e vendimeve të mundshme nga Gjykata Administrative e Apelit nëse do të paraqiten ankime nga këta kandidatë.

Në lidhje me vënien në dijeni të Kuvendit si organi i emërtesës e që mund të mbajë një qëndrim për këtë situatë për t'ia përcjellë KED-së, anëtarët e Këshillit shprehën qëndrimin se detyrimi i Këshillit është të njoftojë të gjithë subjektet e ftuar për të marrë pjesë në mbledhje dhe ata e vlerësojnë vetë praninë e tyre. Nga ana tjetër, KED është organ kushtetues i pavarur dhe kërkime e dhënia e mendimit nga Kuvendi do të ishte një lloj vendimi politik që do të mendohej se i imponohet Këshillit për këtë çështje, ndërkohë që përgjegjësinë kushtetuese për rishpalljen ose jo të vakancës e ka KED.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe shprehet se përtej diskutimit, për momentin asgjë nuk prish nëse Këshilli vendos sot pezullimin e kësaj procedure deri në përfundimin e procesit ankimor, për efekte të një të drejte efektive ankimi dhe të mbetet në pritje të vendimmarrjes së gjykatës. Kemi afatet 7 apo 10 ditor deri në mbledhjen për të vendosur rreth të asaj çfarë u diskutua, nëse ka vend për të rishpallur vakancën apo për të vijuar. Por, në asnjë rast intervistat me kandidatët e lejuar nuk mund të kryhen sot.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve të tyre vendosën që vendimi për të rishpallur ose jo vakancën për Inspektor i Lartë i Drejtësisë në kushtet kur, ndryshe nga rastet e vakancave në Gjykatën Kushtetuese ku janë organet e emërtesës që marrin vendimin, ndërsa në këtë rast është vetë KED që duhet të marrë vendimin, të shtyhet deri në për në një mbledhje tjetër, duke konsideruar mundësinë e ushtrimit të ankimit nga kandidatët e ndaluar pranë Gjykatës Administrative të Apelit dhe kohëzgjatjen e procedurave të mundshme të gjykimit të tyre. Ndërsa kandidatët e lejuar deri më tani për këtë vend vakant të njofton që intervista në kuadër të procedurës së vlerësimit nuk do të kryhet, veprim për të cilin do të njoftohen nga Këshilli në kohën e duhur.

Këshilli, pas përfundimit të shqyrtimit të kësaj pikëe të rendnit të ditës, edhe me qëllim përgatitjen e duhur për vijimin me pikën e tjetër të intervistave me kandidatët e lejuar për katër vende vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon me shqyrtimin e çështjeve të pikës tjetër të rendit të ditës, relativisht për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidaturës dhe zhvillimi i intervistave me pesë kandidatë të lejuar për katër vende vakante, dhe **Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** informon se këto katër vende vakante janë vakanca e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 7.02.2018, vakanca e shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018, vakanca e

shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019 dhe vakanca e shpallur nga Kuvendi në datë. 04.03.2019. Kandidatet për tu intervistuar në këtë mbledhje janë znj.Arta Vorpsi, znj. Elsa Toska, znj.Fjona Papajorgji, znj.Regleta Panajoti dhe znj. Marsida Xhaferllari.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, informon se, sipas procedurës së parashikuar në pikën 53 të vendimit normativ të KED me nr.5/2019, përpara se të thirret në intervistë kandidatja e parë, verifikohet paraqitja në cilësinë e ekspertit të pedagoges së përzgjedhur nga Këshilli për vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhës angleze, Dr. Adelina Brahimi.

Thirret ekspertja Dr. Adelina Albrahimi.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, ashtu siç është vepruar edhe në mbledhjen e mëparshme gjatë intervistës me kandidatin Besnik Muçi, i shpjegon ekspertes Dr. Adeliانا Albrahimi, parashikimin në ligj dhe në aktet e KED mbi qëllimin, mënyrën e zhvillimit dhe rëndësinë e detyrës së saj në kuadër të procedurave të vlerësimit të kandidaturave, ku përfshihet edhe niveli i zotërimit të gjuhës së huaj nga secili kandidat që ka shprehur vullnetin për të kryer këtë veprim.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani lexon formulën e betimit për ekspertin: “I vetëdijshëm për përgjegjësinë morale dhe ligjore për detyrën që marr përsipër, do ta kryej bazuar në stadardet profesionale, me ndershmëri e drejtësi dhe do t ruaj konfidencialitetin për të gjitha të dhënat që lidhen me ekspertimin”.

Ekspertja Adelina Brahimi pasi dëgjoji formulën e betimit, deklaron: “Betohem”.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon ekspertin se, sipas rregullave që kemi miratuar në procedurën tonë, bëhet me dije se kandidati që intervistohen janë znj.Arta Vorpsi aktualisht është këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese, znj.Elsa Toska e cila është këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese, znj.Fjona Papajorgji është këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese, gjyqtarja Regleta Panajoti dhe kryeinspektorja në detyrë e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Znj.Marsida Xhaferllari.

Pyetet ekspertja Dr. Adelina Albrahimi nëse i njeh dhe a është në marrëdhënie papajtueshmërie apo konflikti interesi me ndonjërin nga kandidatët.

Ekspertja Adelina Brahimi, deklaron që nuk kam shkak papajtueshmërie apo konflikt interesi me asnjërin nga kandidatet.

Thirret kandidatja Arta Vorpsi për zhvillimin e intervistës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon znj. Arta Vorpsi se sikurse është në dijeni, kjo intervistë zhvillohet në zbatim të ligjit dhe të rregullave normative të Këshillit në kuadër të procesit të vlerësimit të kandidaturës së saj. Ftohet kandidatja të vlerësojë dhe përgjigjet duke deklaruar nëse është në kushte papajtueshmëri apo konflikti interesi me anëtarët e Këshillit, me dy pjesëtarët e tjerëve në mbledhje që janë Avokatja e Popullit dhe përfaqësuesi i Presidentit të

Republikës. Gjithashtu, i bëhet me dije që, për pjesën e intervistës që ka të bëjë me nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, eksperte e thirrur nga KED është Dr. Adelina Brahimi për gjuhën angleze që është në të majtën tuaj.

Kandidatja Arta Vorpsi deklaron se, në dijeninë e saj nuk konstaton asnjë situatë papajtueshmërie apo konflikt interesi me anëtarët e Këshillit dhe të tjerët.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidaten se intervista që zhvillohet me të dhe me secilin nga kandidatët e tjerë, sigurisht që nuk ka të përcaktuar në mënyrë formale të ketë një kufi kohor, por gjithsesi është e kuptueshme që duhet të jetë racionale, njëkohësisht duke realizuar edhe qëllimin që ka intervista. Së pari, kandidatja ka mundësinë dhe hapësirën të paraqisë para Këshillit motivimin e kandidimit, të cilën e ka me shkrim dhe nëse mund ta parashtroni në mënyrë të përmbledhur. Pas parashtrimit të lirë, do të vijohet me pyetjet që eventualisht mund të kenë anëtarët e Këshillit në drejtim të kandidates tuaj, të cilat ti vlerësojë vetë për përgjigjen që mund të jepet për secilën nga pyetjet.

Kandidatja Arta Vorpsi merr fjalën dhe pasi falënderon për mundësinë e marrjes së fjalës dhe parashtrimit të përmbledhur të platformës, vizionit të kandidimit dhe ndoshta objektivave që mendon se duhet të ketë një kandidate për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, të cilën e ka përgatitur me shkrim për ta dorëzuar në këtë mbledhje.

Ndër të tjera parashtron se, duke u shprehur se jam e sigurt që ju jeni njohur edhe me dosjen time dhe e keni dijeninë mbi përgatitjen time profesionale dhe kriteret ligjore dhe kushtetuese. Megjithatë, në mënyrë të përmbledhur, mund të them që kam një përvojë mbi 23 vjeçare si juriste dhe shumicën e këtyre viteve, për mos të thënë se deri në 90% të tyre, e kam të lidhur ngushtësisht me të drejtën publike dhe specifikisht me të drejtën kushtetuese dhe të drejtat e njeriut. Gjate gjithë jetës time profesionale kam qenë aktive, jo vetëm në punën e përditshme ku kam dhënë kontributin kryesor, i cili ka qenë pranë Gjykatës Kushtetuese, por kam qenë aktive mjaft edhe në aktivitetin akademik dhe shkencor. Që do të thotë që prej shumë vitesh jam lektore e të drejtës kushtetuese, e të drejtave të njeriut, e të drejtës kushtetuese të krahasuar në fakultetet publike dhe ato private. Në fakultetin publik në Universitetin e Tiranës, kontributi im ka qenë që në nivelin bachelor, në nivelin master dhe në studimet doktrate, pra në udhëheqjen e studentëve të doktoraturës. Gjithashtu kam një aktivitet shkencor dhe akademik të pasur duke ju referuar botimeve që kam brenda dhe jashtë vendit në gjuhën shqipe dhe të huaj, anglisht dhe Gjermanisht. Kam marrë pjesë në mjaft projekte si eksperte ligjore, në përgatitje të analizave ligjore për çështje të ndryshme, kryesisht të përafrimit të legjislacionit shqiptar me standardet jo vetëm të të Drejtës Evropiane, por dhe të të drejtës ndërkombëtare specifikisht për aktet ndërkombëtare, marrëveshjet ndërkombëtare që Shqipëria i ka ratifikuar dhe duhet ti zbatojë. E lashë për në fund, por jo më pak

të rëndësishëm, një aktivitet i imi kryesor ka qenë ai i drejtores në drejtorinë e studimeve dhe botimeve pranë Gjykatës Kushtetuese dhe më pas prej 2005 si këshilltare ligjore e gjyqtarëve. Mendoj se këto janë disa arsye të mira dhe të forta për të aplikuar për një vend në Gjykatën Kushtetuese duke qenë se e njoh mirë atë institucion. Sigurisht jo vetëm nga pikëpamja organizative e brendëshme por dhe nga pikëpamja substanciale e saj, nga pikëpamja thelbësore. Mendoj që kandidatura ime është e përshtatshme për shkak se jam shumë e orientuar dhe kjo do më bëjë të jem me përparësi me kandidatet e tjerë që mund të vijnë jashtë sistemit. Kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë që Gjykata Kushtetuese duhet të përbehet vetëm nga kandidatë që vijnë nga brenda Gjykatës Kushtetuese. Por, nga përvoja ime në atë institucion, kam vënë re që një miksim i përvojave dhe duke pasur parasysh miksimin midis përvojave gjyqësore dhe akademike dhe sidomos kur kjo përvojë akademike vjen dhe nga vetë nga brenda Gjykatës Kushtetuese, ndikon mjaft në kuptimin sa më të mirë të natyrës së gjykimit kushtetues, duke lehtësuar deri diku punën dhe përshtatjen e kandidatëve dhe gjyqtarëve që vijnë jashtë këtij sistemi. Me këtë dua të them që përvoja ka treguar që gjyqtarët të cilët janë të larguar disi ose gjyqtarët që kanë qenë të larguar disi nga gjykimi kushtetues kanë dashur relativisht një kohë të caktuar për tu përshtatur me konceptet e gjykimit kushtetues. Kjo ka dhe arsyet e veta sepse duhet të jemi koshient që gjykimi kushtetuese është një gjykim relativisht i ri në Shqipëri. Unë kam qenë një nga pedagoget e para që kam filluar të jap lëndën e të drejtësisë kushtetuese në fakultet për të kuptuar që gjykimi kushtetues duhet ndarë nga pjesa materiale e të drejtës kushtetuese. Kështu që ka një sërë arsyesh. Unë nuk dua të zgjatem më me këtë. Në çështjen e motivimit, arsye tjetër që besoj që i plotësoj të gjitha kriteret të vendosura nga Kushtetuta dhe nga ligji, është se kam edhe cilësitë e duhura të integritetit moral dhe profesional për të bërë atë punë. Mund të zgjatem tek pjesa e motivimit nëse ju doni të vazhdoj me diçka tjetër, me pikë tjetër ose me pyetjet .

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani shprehet se mund të vazhdoni ende të parashtroni motivimin tuaj. Është pak e kufizuar në kohë, por kjo nuk do të thotë që t'ua kufizojmë ato që janë linjat kryesore që ju mendoni. Pra të mos lini çështjet dhe elementët që ju i vlerësoni se duhet ti parashtroni.

Kandidatja Arta Vorpsi merr fjalën dhe shprehet se një diçka tjetër që doja të shtoja meqënëse më dhatë mundësin që të vazhdoj me parashtrimin, është edhe nevoja ndoshta për ti vendosur disa sfida të reja Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese edhe tre vjet po i afrohet 30 vjetorit të krijimit të saj. Dhe gjithashtu është në një moment mjaft delikat dhe nuk e kam fjalën për çështjen e plotësimin të saj, të funksionimit. Por e kam fjalën tek ndryshimet kushtetuese dhe ligjore që kanë ndodhur në funksionet e këtij institucioni. Që do të thotë që ka disa sfida jo të vogla për ti aritur . Dhe në këtë kontekst e shikoj si mjaft të rëndësishme zgjedhjen

e kandidaturave që do të mund ti japin këtij institucioni atë profilizim që i duhet realisht atij institucioni në prag të 30 vjetorit të krijimit. Por edhe në funksion të integritit të Shqipërisë në strukturat evropiane apo në Bashkimin Evropian. Me këtë dua të them që Gjykata Kushtetuese sot është në ato institucione që i bën nder shtetit Shqiptar, pasi ka arritur jo vetëm të evidentojë standardet më të larta të shtetit të së drejtës në Shqipëri, por jam e bindur që jetën politike sociale të Shqipëri e ka bërë shumë më të mire se sa do kishte qënë pa të. Dhe fakti i kësaj periudhe që nuk po funksionon Gjykata Kushtetuese, po e vërteton më së miri këtë gjë. Për ditë po theksohet nevoja që do të kishim pasur një paqe në disa raste nëse do të kishim pasur një Gjykatë Kushtetuese funksionale. Gjithsesi në funksion të kësaj që po them nuk duhet parë vetëm aspektin politik. Ajo që dua të theksoj është se Gjykata Kushtetuese ka sfida më të rëndësishme. Pasi unë mendoj se standardet e funksionimit të shtetit të së drejtës janë vendosur tashmë nga Gjykata Kushtetuese. E vetmja gjë që duhet të bëjnë institucionet shqiptare është ta zbatojnë atë. Ajo që unë e shikoj si sfida është arritja e standardeve të reja. Personalisht kam mendimin që Gjykata Kushtetuese duhet të kalojë në një fazë tjetër, në atë të vendosjes së standardeve që lidhen me lirinë sociale ekonomike.

Këtu për fat të keq kemi mbetur pak mbrapa kemi vendosur disa standarde që lidhen me lirinë ekonomike kur kjo ka qënë në funksion të subjekteve të biznesit që është shumë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit. Por në aspektin e lirive individuale unë them që Gjykatës Kushtetuese i takon të bëjë me shumë dhe pas reformës 2016 e ka mundësin dhe më të madhe sepse i është krijuar dhe kuadri i përshtatëm kushtetues dhe ligjor që i jep mundësin individit të paraqesë ankimin kushtetues individual në rastin se cenohen lirit dhe të drejta akt themelor të tij. Unë pres me pa durim dhe jam shumë kurioze në ç'linjë do të shkojë Gjykata Kushtetuese lidhur me këtë liri dhe të drejtat themelore.

Sigurisht një sfida tjetër shumë e madhe po besoj që e kanë çarë rrugën gjykata homologe evropiane është dhe çështja integritit përshtatjes legjislativ kombëtar vendas me atë evropian duke filluar nga Kushtetuta e këtij vendi e cila mendoj që do të nënshtrohet disa ndryshimeve për tu përshtatur me rendin e ri juridik evropian. Edhe pse Kushtetuta jone është miqësore ndaj të Drejtës Evropiane përsëri do të ketë sfidat e veta. Kështu që mendoj në këtë kontekst Gjykatës Kushtetuese i duhen gjyqtarë të cilët të mos jenë thjesht gjyqtarë evropian në kontekstin gjeografik, por të mendoj si gjyqtarë evropian duke pasur parasysh që jemi tashmë nuk mund të quhet Gjykata Kushtetuese Shqiptare Gjykata e Re. Sepse një gjykatë që po i afrohet 30 vjetorit nuk mund të quhet me e re. Në kontekstin e njohjes dhe e përmirësimit të mënyrës se si funksionon Gjykata Kushtetuese nisur nga fakti që thash që e njoh Gjykatën Kushtetuese nga brenda por kam pasur fatin të kontribuoj në ngritjen e disa strukturave dhe të akteve të

brendshme të Gjykatës Kushtetuese, në fakt jo vetëm të brendshme por kam pasur fatin që në 2016 që të jem pjese e sekretariatit teknik dhe të grupit të eksperteve që është mare me hartimin e ndryshimeve kushtetuese por dhe ligjit për Gjykatën Kushtetuese specifkash.

Kështu që mendoj se kuadri rregullator kushtetues dhe ligjor është në vend pra është i pranishëm. Ajo që duhet që nevojitet tani është përshtatja e pjesës organizative funksionale e Gjykatës Kushtetuese me këtë kuadër kushtetues dhe ligjor. Aspekti rregullator i brendshëm mungon ende në Gjykatën Kushtetuese për shkaqe objektive që ju tashme i dini me njëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit të ndryshimeve ligjore u morën disa vendime nga mbledhja e gjyqtarëve u bënë dhe disa akte por jo tërësore do të thotë që ende nuk janë bërë ndryshimet e nevojshme rregullatorë të brendshme të Gjykatës Kushtetuese në përputhje me ligjin e ri një aspekt tjetër që unë mendoj që duhet plotësuar është çështja e harimit dhe pasjës së një strategjie afat shkurtër dhe afat mesme në Gjykatën Kushtetuese. Mua me vjen keq në këtë pikë që e pranoj por e kam nga natyra për shkak dhe të mësim dhënies por dhe nga natyra e pëlqej autokritiken pra duhet të evidentojmë gjëra që nuk shkojnë. Gjykata Kushtetuese është ndër të paktat në Shqipëri, në rajon por dhe në Evropë që nuk ka një strategji . Strategjia sigurisht që ju të gjithë e dini që është një nga ato dokumente që përcakton mënyrën politike e të vepruarit institucional në të gjitha aspektet. Jo vetëm në aspektin buxhetor por dhe në aspektin organizativ.

Është e nevojshme të përmirësohet marrëdhënia e Gjykatës Kushtetuese me publikun, e kur them me publikun e them në shumë aspekte nuk e shikoj vetëm me median por me publikun në tërësi. Kemi pasur një marrëdhënie sporadike ndër vite me publikun duke ardhur vetëm nga ai presioni publik për disa çështje të cilat konsiderohen më me efekt ose me efekt më të madh në publik se disa çështje të tjera. Por unë them se ka ardhur nga një mënyre se si Gjykata Kushtetuese operonte në vendimmarrje. Fakti që para ndryshimeve ligjore gjykata merrte një vendim duke deklaruar vetëm diapozitivin dhe arsyetimi jepej shumë kohë më vonë. Që është një nga problemet që u ezaurua me ndërhyrjet ligjore të bëra në 2016 kjo ndoshta i jepte pak mundësi për të qenë më pak transparent me publikun që gjykata pse e mori këtë apo atë vendim. Dhe kjo ka qenë një nga gjërat që na ka shqetësuar sepse publiku e dine që gjykata kishte shfuqizuar një ligj apo e kishte rrezuar ndërkohe nuk diheshin arsyet pse. Dhe unë mendoj që këtu gjykatës i takon të bëjë shumë më tepër jo vetëm të japi rezultatin por të japi dhe logjikën pas atij rezultati. Njoftime apo kontaktet e vazhdueshme me publikun janë shumë të rëndësishme sepse e para i shërbejnë Gjykatës Kushtetuese sepse e bëjnë atë më të pranueshëm e bëjnë më të pëlqyeshme për shkak sepse publiku e di që ky institucion është transparent .Në ka një element që ka qenë në mangësi në Shqipëri në institucionet shqiptare është transparenca një gjë te cilën ky këshill i nderuar e ka ditur ta respektoj mjaft mirë pasi për mua ka qenë një surprize që çdo lloj mbledhje

çdo njoftim çdo vendimmarrje e jua është publikuar në një kohe shumë të shpejt. Nuk i kam ndjekur institucione e tjera kohët e fundit pasi kam qenë e fokusuar tek ky institucion. Por mendoj marrëdhënia me transparencën marrëdhënia me publikun për të qenë pranë publikut për të qenë i kuptueshëm në vendimmarrje që i jep publiku është shumë i rëndësishëm përveç se është një detyrim ligjor . Nuk doja ta thoja këtë sepse duket sikur ka ndonjë tendencë për të mos zbatuar ligjin por nuk është e vërtetë pasi unë e thash që gjykata formalisht e ka bërë këtë gjë, ajo që unë mendoj se duhet të përmirësohet është mënyra e thelbit në marrëdhënie me publikun dhe mënyra se si përçohet tek publiku vendimtarja . Kjo nuk ka të bëjë vetëm me vendimet apo me publikimin diapozitivave të vendimeve por kjo ka të bëjë më ndërtimin e marrëdhënieve të cilat mund të dalin ndoshta pak nga ai aspekti i ngurtë që ka gjykata përgjithësisht. Në e kemi parë që në mjaft qytete të Evropës ekziston dita e dyerve të hapura ku çdo qytetar i thjesht mund ta aksesor Gjykatën Kushtetuese. Është përpjekur gjykata herë pas here kur ka pasur përvjetor të bëjë një lloj sensibilitet por kjo mendoj unë nuk duhet të jetë sporadike dhe e rrallë duke e lënë përvjetorëve apo datave të shënuara.

Diçka tjetër që unë e shikoj dhe nga pikëpamja edhe e akademikut le të themi dhe e profesores të së drejtës është çështja e marrëdhënieve profesionale ose e marrëdhënieve me gjykatat e tjera brenda vendit ose me praktikant të së drejtës brënda vendi po dhe jashtë vendit para shumë vitesh duke qenë se unë kame shumë vite në Gjykatën Kushtetuese dhe e njoh mire historinë për shkak se kam qenë dhe drejtore e Drejtorisë së Studimeve Gjykata Kushtetuese ka Organizuar shumë aktivitete, seminare, tryeza të rumbullakëta madje dhe me Gjykatën e Larte pavarësisht se disa prej tyre ishin edhe pak të nxehta diskutimet për shkak të përplasjes juridiksioneve herë pas here por ishin shumë të dobishme. E kemi pasur edhe me gjykata e tjera të rajonit edhe me gjykatën e Evropiane dhe ishte diçka shumë e mire sepse jo vetëm gjyqtaret shkëmbejnë përvoja por edhe stafi dhe ndërkohe ishim në koherent dhe të përditësuar edhe me vendimmarrjen e gjykatave të tjera për ti paraprirë vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese. Për fate të keq nuk e di pse erdhi duke u zbehur kjo lloj marrëdhënie të cilën unë them se është shumë e nevojshëm ta rivitalizojmë ta rikthejmë në jetë edhe njëherë sepse Gjykata Kushtetuese ju e dini, mua më pëlqen ta ritheksoj se nuk është një gjykate e zakonshme nuk është një gjykate që duhet të mbyllet në trupën dhe të marri një vendim dhe ti japi zgjidhje çështjes. Gjykata Kushtetuese është me tepër se kaq. Gjykata Kushtetuese është një institucion i cili duhet të reflektoj ose të rrezatoj në të gjitha institucionet publike, përfshire gjykatat apo çdo institucioni tjetër dhe publikun dhe respektimin e Kushtetutës. Kjo ka shumë mënyra për tu bërë nuk ka të bëjë vetëm më vendimmarrjen formale nuk behet me botimin e vendimeve kjo bëhet dhe me anë të aktiviteteve të tjera . Unë ju them gjithmonë dhe studenteve të mi që kur të vij dita që Gjykata

Kushtetuese kur të ketë sa më pak vendime që shfuqizojnë apo që godasin aktet e pushtetit publik aty kemi arritur pikën më të lartë të zhvillimit të shoqërisë të shtetit Shqiptar. Ajo që dua të them që gjykatësi i Gjykatës Kushtetuese dhe të parandaloj shkeljet e mundshme dhe kjo mund të bëhet me shumë më tepër veprime dhe mesazhe për veç se me vendimmarrje kur viresh në lëvizje nga subjekti. Besoj që është e mjaftueshme nuk po zgjatem më.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani shprehet se personalisht mora përgjigje nga pjesa e dytë e komunikimit për disa nga pyetjet që mund t'ju bëja, por një pyetje përsëri do ja u bëj: Nëse do të përzgjidheshit si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, si do të vepronit në kryerjen e detyrës? A mendoni se do të vepronit ndryshe nga gjyqtarët paraardhës që kanë qenë në atë gjykatë? Dhe në se po, përse do të vepronit ndryshe?

Kandidatja Arta Vorpsi, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se në fakt është një pyetje shumë e mirë. Por unë do të përgjigjem shumë thjesht dhe nuk është çështje as ndrojtje dhe as padijenje apo shmangje. Është një çështje që unë ripërsëris, po jo paqëllim, faktin që unë e bëj prej shumë vitesh punën e këshilltarit ligjor dhe në fakt, puna e këshilltarit ligjor, pavarësisht se ka qenë deri në fazën e këshillimit të gjyqtarëve dhe në asistimin e tyre, ka qenë për mua dhe për mjaft nga kolegët e mi, por unë flas për vetë, e barabarte me atë të gjyqtarit. Që do të thotë se çështja është parë në kontekstin sikur unë do të vendos për çështjen. Sepse është e vetmja mënyre që një këshilltar mund të përgatisë një relacion gjithëpërfshirës, pa lënë jo vetëm asgjë jashtë, po pa lënë konsideratën e mjaftueshme për asnjë fakt. Të paktën kjo ka qenë mënyra e të vepruarit e imja dhe kjo nuk ka përfunduar deri në fazën e relacionit, por kjo ka vazhduar dhe në fazën e diskutimit të çështjeve me gjyqtarët përkatës apo me kolegjet ose mbledhjen e gjyqtarëve sipas rastit. Më tej ka vijuar deri në hartimin e projekt vendimeve që do të thotë praktikisht se, pavarësisht se kam qenë në detyrën e këshilltarit defakto ne kemi bërë punën e gjyqtarit dhe kjo gjë është e provuar. Sigurisht unë arrij ta bëj dallimin sepse vendimmarrja nuk ka qenë e jona . Unë nuk kam pasur ndonjë person si idhull për të thënë që kur të bëhem gjyqtare do të vendos si ky person. Nëse do ta marrim gjykatën si organ kolegjal, unë do të thoja këtë që unë do të përpiqem, nëse do të bëhem gjyqtare, të zbatoj të gjitha standardet më të mira që janë vendosur në atë gjykatë dhe janë mjaft të tilla . Nëse do të këtë vend për të bërë më mirë sigurisht që do të bëhet më mirë. Por jo e shtyrë vetëm nga fakti që meqenëse e kanë bërë ata me përpara, unë do ta bëj ndryshe meqenëse e kam këtë mundësi. Nuk është ky motivi për të cilin unë dua të bëhem gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese .

Vitore Tusha merr fjalën dhe shprehet se kisha vendosur të mos bëja asnjë pyetje, por një pyetje do ti bëj Zj. Vorpsi, ngaqë më ngacmoj me gjithë atë që parashtroj. U shpreh pak në lidhje me transparencën që ka qenë pak problematike, por duke u lidhur me vendimet, kohën e shpalljes

së arsyeve të vendimit dhe e kuptova tërësisht. Si e mendoni ju ta përmirësoni këtë çështje? Jo gjithmonë në drejtimin e arsyeve që ju thate si arsye problematike, por a ka vend ta lidhim këtë çështjen e mungesës së transparencës edhe duke e lidhur gjykimin me dyer të hapura: Sa e ka zbatuar dhe si e ke pare çështjen e respektimit të këtij kriteri transparence të lidhur me gjykimin me dyer të hapura që është një parim po kaq i rëndësishëm i gjykimit të drejtë përmes një procesi të rregullt ?

Kandidatja Arta Vorpsi, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se në fakt mund të duket kjo që po them tani pak si kontradiktore por nuk është. Pse e them? Sepse nëse ka pasur një gjë që Gjykata Kushtetuese e ka bërë me tepër dhe kur s'ka qenë e nevojshme është bërja e seancave të hapura. Por unë e thashë dhe në përgjigjen time që nuk është vetëm kjo mënyra për tu bërë transparent. Fakti që ti hap gjithçka prapë mund të mos jesh transparent sepse mund të jesh i pakuptueshëm për publikun. Mua më shqetëson marrëdhënia e Gjykatës Kushtetuese me publikun, për t'iu afruar publikut sepse seanca është bërë e hapur ndoshta pa sjellë ndonjë gjë të re për seancën. Besoj se edhe të pranishmit e dinë se Gjykata Kushtetuese operon mbi bazë dokumentacioni që çdo gjë paraqitet përpara dhe seanca është për të sqaruar ndonjë çështje që mund të jetë e pa qartë nga dokumentet dhe jo detyrimisht duhet të bëhet seancë . Unë kam pasur mendimin që në mjaft raste mund të shmangej seanca sepse realisht nuk sillte ndonjë gjë të re për gjykimin dhe në këtë kontekst dua të them që nuk është e rëndësishme se sa seanca publike bëhen, është e rëndësishme se si e përçojmë vendimmarrjen tek publiku.

Vitore Tusha merr fjalën dhe shprehet se ju e bëtë shumë mirë dallimin e seancave me dokumente dhe seancave publike. Por përgjigja që doja nga ju në këtë moment lidhet me faktin që a ka mundur gjykata institucionalisht apo formalisht që kur ka marrë vendim të zhvillojë gjykimin me dyer të hapura e ta përçojë këtë në seancën e saj? Duke i marrë të mirëqena ato që thatë e që lidheshin me transparencën dhe me gjykimin, Gjykata Kushtetuese sot ka një sallë që nuk është më e madhe se kjo këtu jemi duke vepruar në mënyrë të mbyllur. A do të bëni ju diçka më të mirë në të ardhmen? A mendoni që do të keni fuqinë që në marrëveshje me pushtetet e tjera të kemi mundësinë që të kemi një gjykatë me një sallë të paktën të ngjashme me këto të vendeve të rajonit?

Kandidatja Arta Vorpsi përgjigjet se e kuptova pyetjen, por nuk e mendova që bëhej fjalë për këtë aspekt, tani jam e qartë. Është e vërtetë që në fakt ajo sallë ku zhvillon seancat Gjykata Kushtetuese nuk është dinjitoze për një gjykatë kushtetuese. Dhe këtë ne e dimë, është një fakt i pranuar botërisht. Çështja e përmirësimit të infrastrukturës të Gjykatës Kushtetuese është që nga viti 1992, që kur ajo është krijuar. Është ngritur disa herë, e di që ka pasur disa përpjekje qoftë nga drejtuesi, qoftë nga mbledhja e gjyqtarëve. Nuk e di ka pasur shumë arsye përse nuk është

zgjidhur. Unë nuk jam në gjëndje të them a do ta bëj unë, por jam në gjëndje të them se nuk do rresht së kërkuari një gjë të tillë. Pastaj se sa e mundur do të jetë kjo është një çështje vetëdijësimi e institucioneve që e kanë mundësinë dhe detyrën për ti dhënë mundësinë Gjykatës Kushtetuese për të bërë seanca në mënyre dinjitoze sepse po të vazhdojmë edhe më tej nuk është vetëm salla ku bëhen seanca problematike. Realisht dhe zyrat defakto janë shumë pak për atë staf dhe për atë kapacitet që Gjykata Kushtetuese përfaqëson .

Arta Marku merr fjalën dhe shtron pyetjen se në këndvështrimin tuaj, cilat duhet të jenë prioritetet që Gjykata Kushtetuese duhet të ndjekë menjëherë pas vënies së saj në funksionim ?

Kandidatja Arta Vorpsi përgjigjet se e përmenda pak shkarazi për të mos u ndalur me gjatë. Por, së pari, në eventualitetin që Gjykata Kushtetuese të jetë në mos 100% por të paktën në atë formë që të këtë mundësi të marrë vendime dhe këtu nuk e kam fjalën vetëm për çështjen e kërkesave sepse sigurisht ajo është më parësore për të mos zgjatur dhe më tepër afatet e kërkesave që janë paraqitur tashmë. Por edhe në aspektin e vendimeve që duhet të marrë mbledhja e gjyqtarëve për çështje të organizimit të brendshëm sepse të gjitha këto janë të lidhura me njëra tjetrën. Prioriteti që ka Gjykata Kushtetuese është gjithmonë që vendimmarrja e saj të jetë brenda një afati të arsyeshëm, të jetë cilësore e në shërbim të palëve. Në këtë kontekst ne kemi një numër të caktuar çështjesh, i cili nuk është dhe aq shumë problematik, diku mbi 100 kërkesa të cilat janë në faza të caktuara ashtu si erdhi edhe zhvillimi i ngjarjeve, që do të thotë që disa kaluan në seancë dhe duhet të marrë vendim dhe disa janë pranë relatorit për tu paraqitur për kolegji. Të tjerat janë në përpunim në fazën që ndihmësi ka bërë relacionin dhe presin ti caktohen gjyqtarit. Primarja është që Gjykata të mos tejkalojë afatin e arsyeshëm në gjykimin e çështjes sipas radhës dhe rëndësinë që ato kanë sepse kjo gjë duhet parë rast pas rasti për çështjet. Ndërkohë po prioritet mbetet edhe plotësimi i kuadrit rregullator të brendshëm. Siç e thashë. për mendimin tim. është emergjente plotësimi i miratimit të rregulloresë brendshme dhe rregullores së gjykimit. Pasi me ligjin e ri ato janë ndarë. Ne kemi rregulloren e procedurave gjykimore dhe rregulloren e brendshme që lidhet me stafin. Për mua këto janë prioritete.

Fatri Islamaj merr fjalën dhe shprehet se gjatë fjalës tuaj më bëri përshtypje dhe këndvështrimi i prezantimit të vizionit tuaj, për këndvështrimin tuaj personal se si mund të konkludohet në aspekte të ndryshme të gjykimit kushtetuese apo të performancës së Gjykatës Kushtetuese nesër, në aspektin strategjik. Ndërsa një prej aspekteve që ju prezantuat ishte edhe një objektiv që ju e shprehet me fjalët që një nga standardet e rritjes së kushtetueshmërisë ose të ndërgjegjes kushtetuese dhe për institucione të tjera do të ishte, do të mund të vlerësohej nga një tregues që ju e thatë si cënimi apo shfuqizimi i sa më pak akteve ligjore apo nënligjor që mund të

ishin objekt i kërkesave drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Në ç'mënyrë mendoni që Gjykata Kushtetuese mund të kontribuojë në këtë aspekt ?

Kandidatja Arta Vorpsi, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se në fakt vizioni apo ajo dëshirë që unë kam është diçka që unë e shoh të realizuar në të ardhmen. Pra nuk është një gjë që mund të ndodhë shpejtë. Por Gjykata Kushtetuese mund të kontribuoj dhe kontribuon madje në çdo vendim që ajo jep të kësaj natyre, duke konstatuar shkeljet e një organit publik çfarëdo lloj organi qoftë ky, duke përfshirë edhe gjykatat. Ajo që unë po përpiqem e që doja të thoja është kjo që nëse Gjykata Kushtetuese konstaton që ka një shkelje kushtetutshmërie është e pritshme dhe e preferueshme në një shtet demokratik që ajo të mos përsëritet. Dhe në këtë kontekst them që Gjykata Kushtetuese me vendimet e saj ka rolin e efektit rrezatues që jep për të gjithë institucione dhe kjo është arsye pse vendimet e Gjykatës Kushtetuese citohen nga institucione të tjera dhe nga vetë vendimet e gjykatave të zakonshme e që unë e përgëzoj se e shikoj që vitet e fundit ka një rritje të citimit dhe të referimit të Gjykatës Kushtetuese për të treguar që ky tashme është një standard i njëjtë i barabartë me atë që ka vendosur Kushtetuta dhe duhet respektuar. Më tepër se kaq Gjykata Kushtetuese nuk mund të bëj sepse është një gjykatë që ka për detyrë të interpretojë në fund të fundit Kushtetutën dhe të kontrollojë pajtueshmërinë e akteve me Kushtetutën, sigurisht dhe nëpërmjet veprimtarive të tjera ndërgjygesuese. Por roli i saj gjithsesi është i kufizuar që do të thotë vetë institucionet publike kanë për detyrë ti përshtaten asaj vendimarrje dhe kanë për detyrë të tregojnë vetëpërbajtje brenda kufijve kushtetues të vendosura shprehimisht nga Kushtetuta apo të theksuara apo të interpretuara nga Gjykata Kushtetuese, për të mos rënë në të njëjtin shkelje. Pra kemi pasur raste kur Gjykatës Kushtetuese i është dashur të vendos një herë apo dy herë për të njëjtën çështje. Në qoftë se ajo është thënë njëherë ajo është shkelje. Pra institucionet duhet të kenë vetëpërbajtjen, vetëkontrollin për të mos rënë në të njëjtën shkelje. Prandaj kërkohet një lloj përgjegjshmëri edhe nga të gjitha institucionet jo vetëm nga ai që e jep modelin por dhe nga të tjerët që e zbatojnë atë. Dëshira ime është në qoftë se do të vijë ajo ditë që Gjykata Kushtetuese të mos këtë nevojë të përsërisë në vendimet e saj të njëjtat shkelje. Do të jetë një ditë mbarë për shoqërinë shqiptare .

Margarita Buhali merr fjalën dhe shpreh falenderim për prezantimin dhe se vlerësoj gjithçka që thatë. Ishit shumë e qartë e konkrete në pritshmëritë që ju prezantoni në rast që do të zgjidheni në postin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Unë do të isha pak më konkrete në pyetjet jo të lidhura me institucionin, por të lidhura me atë pozicion që ju keni mbajtur deri tashmë. Njoh eksperiencën tuaj të gjatë ndër këto vite në institucion, dhe duke pasur parasysh eksperiencën doja të shikoja vendosmërinë dhe paanshmërinë se si e keni treguar ju. Pytja ime është ka pasur ndonjë rast që mund të keni pasur mendim të ndryshëm si këshilltare në relacionet tuaja nga ai i gjyqtarit

dhe, nëse e keni shprehur hapur këtë mendim, i keni qëndruar relacionit tuaj dhe si ka shkuar më tej çështja në vendimmarrje? Nëse mund të na japësh diçka konkrete në këndvështrimin tuaj .

Kandidatja Arta Vorpsi, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se ka pasur jo një por disa raste. Unë nuk kam bërë ndonjë statistikë me thënë të drejtën por nuk kanë qenë të shumta. Kjo do të thotë që kanë mbizotëruar rastet që gjyqtari relator ka ndjekur qëndrimin tim. Kjo jo për meritën time të jashtëzakonshme, jo patjetër e lidhur me këtë, por edhe me faktin që për mjaft çështje Gjykata Kushtetuese ka krijuar një jurisprudencë e cila sigurisht ndiqet dhe pastaj nuk mund të devijohet. Kjo ka qenë një arsye. Arsyet e tjera kanë qenë objektive e subjektive, pak rëndësi ka. Ka pasur disa raste dhe dua të them këtë gjë që, nëse ka pasur një gjë të mirë ai institucion aty dhe puna ime si këshilltare ligjore aty ka qenë që ne kemi qenë tërësisht të lire për të përgatitur tërësisht relacionet dhe opinionet tona pa asnjë lloj ndërhyrje nga gjyqtari apo gjyqtarët deri në momentin që është marrë vendimi. Nuk kemi pasur asnjë lloj kufizimi. Madje kemi pasur dhe lirinë për të thënë që nuk kam mendim për zgjidhje përfundimtare të çështjes sepse nuk krijoj dot bindje. Nuk më ka ndodhur ta them shpesh këtë, të mbaj këtë qëndrim, po di që e kam mbajtur njëherë, ka qenë një çështje shume teknike. Ka qenë çështja e caktimit të kufijve detare me Greqinë dhe ka qenë çështje fakti nëse ishte marrë me shumë apo me pak hapësirë ujore. Por ishte shumë teknike dhe unë atëherë thash nuk jam në gjendje për këtë pikë të jap mendim, por i sugjeroj gjykatës të marrë ekspert. Por nuk u mor për shkak se koha ishte shumë e shkurtër e vendimmarrjes. Për të përmendur një rast konkret në fakt, ajo që më vjen në mend tani është çështja që ka qenë e lidhur, më e reja, sepse ka pasur dhe raste të tjera, por me thënë të drejtën siç e thash nuk e kam bërë këtë kërkim. Ka qenë shqyrtimi i fundit mbi ligjin për pronat. Ka qenë një çështje ku unë kam qenë këshilltare dhe unë kam pasur një mendim tërësisht të ndryshëm me vendimmarrjen e gjykatës dhe asnjë gjë s'ka ndodhur. Kam dhënë mendimin tim por gjykata vendosi ndryshe. Por puna jonë ka qenë e tillë. Pavarësisht vendimit që merr gjykata, draftin e parë të projektvendimit e shkruan këshilltari. Kështu që unë duke marrë linjat e vendimmarrjes nga mbledhja e gjyqtarëve, përgatita projektvendimin. Megjithatë mund ta them me kënaqësi që pjesa e opinionit tim gjeti pasqyrim në mendimin e pakicës. Dhe kjo ka qenë një praktikë deri diku e zakonshme. Pra nëse krijohej një pakicë gjyqtarësh, me apo pa relatorin, nuk ka rëndësi për të cilin punon, sepse ne kemi qenë këshilltar të të gjithë gjyqtarëve, ato gjyqtarë mund ta përqafonin atë tek pakica. Kështu në këtë rast nuk më shkoj puna dëm. Shaka sepse puna nuk shkon asnjëherë dëm.

Kandidatja Elsa Toska, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se për përgjigjet. Vlerësoj gjithçka që u tha duke qenë se na e lidhët dhe me çështjet konkrete që i kemi të njohura. Unë do tu bëja dhe një pyetje tjetër që ka të bëjë me kriteret e vlerësimit që ju i jeni nënshtruar komisionit

të pavarur të kualifikimit. Unë e kam lexuar vendimin tuaj. Më ka pëlqyer pjesa e vlerësimit të anës profesionale, por nuk gjeta të pasqyruar në atë vendim rezultatin që keni marrë në testimin e Shkollës së Magjistraturës. Duke qenë se kjo është një nga pikat që është kërkuar në ligj dhe në Kushtetutë. T'ju pyes si ka qenë rezultati juaj në atë testim dhe si e vlerësoni ju në kuadër të vlerësimit dhe të aftësive profesionale atë testim ?

Kandidatja Arta Vorpsi, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se pikët janë aty, ndoshta ju kanë shpëtuar. Në mos gaboj janë diku tek 150 pikë testimi i dytë flas, jo skantroni. Po skantroni që është mbi 60% nëse hyn apo jo në magjistraturë. Në fakt testimi ishte i njëjtë siç bëhej për të gjithë. Veçantia tek ne ishte që u morr parasysh. Kur them për ne, dua të them për këshilltaret e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe ato të gjykatës administrative sepse ne hymë si grup. U mor deri diku parasysh profilizimi ynë. Që do të thotë ne kishim të drejtë të kishim dhe një kazus nga e drejta kushtetuese. Nuk kam asnjë lloj vlerësimi të veçantë ose ankesë për të thënë që ishte një testim që nuk përputhej me standardet. Unë nuk kam marrë pjesë kurrë në ndonjë testim. Ishte hera e parë që merrja pjesë në një testim. Ajo që unë mund të them është kjo që nuk është ai lloj testimi për këtë lloj kategorie profesionistesh. Por kam përshtypjen që Shkolla e Magjistraturës e ka pasur të pamundur për të bërë një testim tjetër, pasi nga ky grup që ne hymë ishin disa prej tyre që donin të bëheshin gjyqtar dhe nëse testi do të ishte i ndryshëm, nesër pasnesër do të ngriheshin pretendime se këta persona që kanë hyrë në magjistraturë kanë hyrë nëpërmjet një testimi jo të zakonshëm por ndoshta të privilegjuar duke e parë në pjesën e proporcionalitetit dhe të qëllimit që u bë nuk kam ndonjë gjë. Ajo jo domosdoshmërisht nxjerrë në paaftësinë profesionale të personit sepse në fund të fundit aty ishin dhe pyetjet të cilat lidheshin me treguesit matematikore të cilat unë nuk e kam fare për turp për të thënë se nuk i zotëroj sepse nuk do të isha bërë juriste. Por siç e thashë gjithmonë për testimet mund të ketë diskutime .

Eriol Roshi merr fjalën dhe shtron pyetjen se si e shikoni raportin me prurjet nga gjyqësori në Gjykatën Kushtetuese? Do të vinë në vazhdim ose më vonë ? Ju ndoshta e prekët por doja të ma sqaronit më mirë.

Kandidatja Arta Vorpsi, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se e preka tek çështja e miksimit. Ajo që them unë është e domosdoshme që të ketë miksim, nuk ka rëndësi sa janë nga gjyqësori e sa janë nga bota akademike. Po të ketë një miksim është shumë e nevojshme, përvoja e gjyqësorit është e jashtëzakonshme. Nuk mund ta injoronim dhe do të ishte gabim po të thoshim duhet të jenë gjyqtar absolutisht. Është një gjë shumë e mirë sepse përvoja e të qenit gjyqtar ka mjaft aspekte shumë të dobishme sepse në fund të fundit ajo si gjykatë funksionon. Nga ana tjetër pjesa akademike gjithmonë zbut pak anën formale të një gjyqtari dhe që ne e dimë se gjyqtari

është i rreptë në frymën dhe në tekstin e ligjit. Ai që vjen nga një përvojë tjetër, qoftë ky avokat, akademik apo profesor i së drejtës sjell ndonjëherë këndvështrime të cilat mund të mos jenë para syve të gjyqtarëve në atë moment. Kjo është e rëndësishme sepse çështjet janë të një natyre të tillë që nuk janë çështje fakti, në shumicën e rasteve. Ato që janë çështje fakti sigurisht që një gjyqtar i trajton pa problem fare sepse e ka përvojën e tij. Kurse çështje te cenimit të së drejtës, lirive themelore, të proporcionalitetit, të kufizimit të tyre, e të hapësirës që ka ligjvënësi për të rregulluar një fushë pa e cënuar Kushtetutën, këto e kalojnë cakun e çështjes së faktit janë çështje gjykimi, çështje vlerësimi në një aspekt më të gjerë kushtetues.

Fatjona Memçaj merr fjalën dhe shprehet se e vlerësoj shumë që jeni një njohëse shumë e thellë e të drejtës kushtetuese. Kam një pyetje rreth njohjes dhe aktivitetit tuaj në procesin penal meqenëse si pjese e jurisprudencës kushtetuese, zënë një vend shumë të rëndësishëm ato të të drejtave të të pandehurit në një proces, në vijim kemi edhe viktimën. Atëherë kam një pyetje. Me sa referuat më përpara, ju listuat disa nevoja për ndryshim, për përmirësim. Ju keni 18 vjet që punoni në atë gjykatë domethënë keni qenë pjesë e administratës civile, keni qenë edhe këshilltare ligjore, ndër këshilltarët më me eksperiencë në gjykatë. Besoj idetë për këto ndryshime ju kanë lindur gjatë kësaj kohe që ju jeni kandidatë dhe thoni ok, unë kam hasur këto gjëra dhe unë dua ti ndryshoj apo ju kanë lindur ndër vite. Nëse ju kanë lindur ndër vite, a i keni pasqyruar dhe a ia keni drejtuar drejtuesit të gjykatës a në mbledhje të gjyqtarëve? Shikoni se përmirësimi i gjykatës do të bëhej edhe në këtë aspekt dhe nëse keni lënë ndonjë gjurmë në një iniciativë të tillë?

Kandidatja Arta Vorpsi, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se lidhur me pyetjen e parë, në fushën e të drejtës penale ose mund të themi më mirë në fushën e të drejtës procedurale penale, unë kam, pasur rastin të përfshihem përveçse në punën time si këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese për çështjet që kam pasur e që me janë caktuar, por dhe si eksperte ligjore. Sigurisht si eksperte ligjore jam fokusuar më shumë tek çështjet e të drejtës penale por që janë të lidhura edhe me garancitë procedurale. Kam bërë analiza për to, kam bërë sugjerime për organizatën që më ka angazhuar për ndërhyrjen në Kodin Penal dhe në atë të Kodin Procedurës Penale. Dhe specifikiht për gjykimet në mungesë para 2017, ka pasur disa projekte të cilat për arsye të ndryshme nuk janë realizuar, nuk janë materializuar në dispozita, por ka edhe nga ato që janë materializuar. Kam bërë një analizë dhe në kuadrin ligjor të neneve të Kodit Penal për pornografinë e fëmijëve. Për përshtatjen e dispozitës që e parashikon atë si vepër penale me konventat ndërkombëtare. Gjithashtu dhe në rastin e dhunës në familje, kryesisht në kuadër të projekteve mbi dhunën në bazë gjinore e të tjera të kësaj natyre. Në aspektin penal lidhur me çështjet që kanë ardhur në Gjykatën Kushtetuese, në gjykatë nuk kanë qenë të ndarë këshilltarët sipas fushës së tyre të ekspertizës. Nuk e kemi pasur këtë luks që të kishim kaq shumë këshilltarë

dhe të zgjedhim. Unë për shembull kam marrë më së shumë çështje të natyrës kushtetuese që do të thotë ligj, kontrolli i ligjeve, i kushtetutshmërisë së ligjeve e të tjerë. Por, ndërkohë, puna e përditshme ishte ajo me çështje që do të binte sipas gjyqtarit. Për shkak se vitet e fundit kam punuar më së shumti me një nga gjyqtaret që ka qenë penalist i njohur, kam pasur dhe më shumë çështje të natyrës penale. Por sigurisht, e thashë, kontrolli që bën Gjykata Kushtetuese nuk hyn në të drejtën materiale patjetër. Rastet janë shumë të rralla që Gjykata Kushtetuese duhet të merret me çështje penale të pastra në aspektin material të kësaj së drejte. Janë kryesisht në nivelin procedural apo shkelje të tilla të cilat e bëjnë procesin të parregullt. Unë mendoj se, duke pasur parasysh natyrën e gjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe kontrollin që ajo bën, njohuritë e mija në fushën penale ose civile në raport me këtë lloj gjykimi janë mëse të mjaftueshme. Për shkak se çështjet i kam të shumëllojshme, të çdo lloj natyre. Jemi marrë për shembull dhe me çështje e të drejtës tregtare që asnjëri nga ne nuk kishte ekspertizën e nevojshme. Por kërkimi shkencor që ne bëjmë është i tillë që ne të gjejmë sa më shumë materiale për të ndihmuar gjyqtarët. Sepse dhe gjyqtarët nga ana tjetër nuk kanë qenë të specializuar në të gjitha fushat e së drejtës. Kemi qenë me fat që kemi pasur gjyqtar që na kanë miksuar ekspertizat e tyre, por nuk ndodh gjithmonë kështu. Këtu na ndihmon kërkimi shkencor pastaj le të themi dhe standardet e së drejtës në përgjithësi.

Sa i përket pyetjes së dytë, unë e cilësova që Gjykata Kushtetuese është një nga institucionet me prestigjioze dhe që realisht ka një nivel mjaft të lartë edhe në mënyrën se si funksionon jo me pa tjetër në atë të vendimmarrjes, por dhe nga mënyra se si funksionon brenda. Unë e thash dhe më parë që këshilltarët kanë qenë tërësisht të lirë në punën e tyre, gjë e cila për hir të së vërtetës, unë kam shume vite që shikoj se nuk është se gjendet kollaj në administratën shqiptare. Ne kemi pasur një liri veprimtarie dhe mendimin për aq sa i lejohej çështjes. Kemi struktura shumë të mira, kemi veprimtari shumë të mira, por unë i shikoj me syrin çfarë mund të behet më mirë. Kështu që në kuadër të përmirësimit, pjesa e marrëdhënieve me publikun kam përshtypjen se kërkon ndoshta një qasje pak më të moderuar. Nuk është çështja që gjyqtarët apo kryetarët që kanë qenë nuk kanë dashur ta bëjnë. Ata përkundrazi kanë bërë goxha brenda kufijve që ata e kanë menduar si të domosdoshëm apo të pranueshëm për gjykimin sepse ka pasur për shembull një lloj ndrojtje nëse japin shumë shpjegime për një vendimmarrje e ndoshta kjo mund të riçelë pyetje të tjera dhe diskutime të tjera. Domethënë është më shumë çështje perceptimi se nuk është çështje vullneti. Asnjëri nga kryetarët dhe gjyqtarët nuk ka thënë që unë nuk dua të jem transparent me publikun sepse ka qenë e vërtetë. Por gjyqtarët, për nga natyra, duke qenë se Gjykata Kushtetuese ka qenë përgjithësisht e përbërë nga gjyqtarë karriere, është pak e ndrojtur kundrejt medias. Për arsye të ndryshme është shume delikate. Disa nga stafi i gjykatës kanë bërë

trajtime për këtë çështje, për marrëdhëniet e gjykatës me median, jashtë dhe brenda vendit. Dhe është çështje shumë delikate. Pra duhet të bësh një strategji dhe duhet të dish realisht dhe të kesh një perceptim që çfarë do ti ofrosh publikut dhe si do tia ofrosh. Nëse e bën në mënyre sporadike dhe të zgjedhur mund të lerë herë pas herë edhe hapësira për keqinterpretim, keqkuptim dhe forma të tjera të këtij lloji .Ajo që dua të them është se nuk ka munguar vullneti nga gjyqtarët për ta pranuar këtë, por ka qenë dhe çështje e vlerësimit objektiv e situatës. Mos harrojmë që Gjykata Kushtetuese është goditur shpesh dhe me pa të drejtë kur ka dhenë një vendim. Është fati i çdo lloj gjykate apo gjyqtari që kur jep një vendim njëra do të jetë e pakënaqur. Në rastin e Gjykatës Kushtetuese goditja është pak më e rëndë sepse efekti i vendimeve që ajo jep për një pjesë të madhe është shume i ndjeshme. Dhe këtu duhet parë çështja që marrëdhënia me publikun të bëhet, por jo në kurriz apo në dëm të punës dhe veprimtarisë së gjykatë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani pasi vëren se nuk ka pyetje te tjera, orienton vijimin e intervistës, në pjesën e dytë të saj, lidhur me vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja. Ekspertja Dr. Adelina Albrahimi ftohet të marrë fjalën dhe të zhvillojë bisedën për aq sa ajo e vlerëson të arsyeshme lidhur me pjesën e njohurive të gjuhës se huaj.

Ekspertja Dr. Adelina Albrahimi zhvillon bisedën e lirë dhe me pyetje përgjigje me kandidaten Arta Vorpsi në gjuhën angleze (koha e kësaj pjese të intervistës 15.00.24–15.07.297)

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani në përfundim të pjesës së intervistës në gjuhën angleze, e njofton kandidaten Arta Vorpsi për përfundimin e intervistës duke falënderuar jo vetëm për angazhimin në intervistë por edhe për dëshirën dhe seriozitetin e përgjigjeve të dhëna.

Kandidatja Arta Vorpsi, duke falënderuar shprehet se ishte një kënaqësi me thënë të drejtën, nuk e mendova që do të kishte kaq shume pyetje. Por u kënaqa që kishte kaq shumë pyetje, ishte një ambient shumë i këndshëm që e bëri shumë të lehtë dhe faleminderit që më dhatë mundësinë për tu përgjigjur. E vlerësoj për shkak sepse jam, jo e para por e dyta që po i ushtrohem një procesi të ri mjaft transparent dhe deri tani të suksesshëm, pavarësisht se si do të shkojë vlerësimi për kandidaturën time. Ju vlerësoj shumë. Ju faleminderit. Punë të mbarë .

Thirret kandidatja Elsa Toska për zhvillimin e intervistës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidaten Elsa Toska se kjo do të jetë intervista që Këshilli do të zhvillojë me ju, në zbatim të parashikimeve që ka bërë ligji dhe rregullat normative që ka hartuar vetë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Përpara se të fillojë intervista, sjell në vëmendje që ju e njihni përbërjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Shikoni që pjesëmarrës në mbledhje janë Avokati i Popullit, në këtë moment nuk ndodhet aty, por është edhe këshilltari juridik i Presidentit të Republikës, zoti Bledar Dervishaj, i cili, sipas ligjit, e

përfaqëson Presidentin në mbledhje, si edhe zonja Adelina Brahim, e cila është pedagoge e brendshme e gjuhës angleze në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës. Ajo që kërkohet prej jush është nëse vëreni situata dhe gjendje papajtueshmërie apo konflikti interesi me cilindo nga pjesëmarrësit dhe emrat të cilët unë përmenda.

Kandidatja Elsa Toska merr fjalën dhe shprehet se nuk kam asnjë konflikt interesi, me asnjë nga anëtarët apo më personat pjesëmarrës në këtë proces.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidaten Elsa Toska se intervista është e ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë është parashtrimi i lirë nga ana juaj i motivimit të kandidimit, sigurisht e thashë edhe me kandidatët paraardhës, nuk jeni të detyruar të jeni shumë e koncentruar, por sigurisht duhet të ketë një kohë të arsyeshme Aq më tepër nëse e keni të shkruar dokumentin, këtu mund të na prezantoni një përmbledhje të tij dhe për të vijuar më pas me pyetjet që eventualisht mund të ketë secili prej nesh në drejtimin tuaj dhe me përgjigjet që ju duhet të jepni. Më pas është pjesa e fundit e intervistës, e cila ka të bëjë me verifikimin e zotërimit të nivelit të gjuhëve të huaja që sipas ligjit bëhet nga Këshilli, por në këtë rast me ndihmën e një profesionisti të fushës që është pedagogia Adelina Brahim, e cila është këtu. Pra, mund të filloni me prezantimin tuaj.

Kandidatja Elsa Toska, pasi falënderon për dhënien e fjalës dhe shprehet se vij para jush dhe për hirë të së vërtetës ndihem krenare. Kështu që ju falenderoj për mundësinë që më dhatë nëpërmjet lejimit të kandidimit. Si kandidate dua të fokusohem në fakt në përgjigjen e pyetjeve që ju do të dëshironit të dinit për mua, si psh ato të tipit pse kam kandiduar? Kujt ia dedikoj rrugëtimin tim deri në këtë kandidim? Sa e përmbush unë profilin e një gjyqtare kushtetuese? A mëshirohen tek unë cilësitë personale dhe profesionale të një gjyqtari kushtetues? Çfarë kontributesh kam dhënë deri tani dhe më e rëndësishmia çfarë vizioni kam unë për Gjykatën Kushtetuese të së ardhmes dhe çfarë kontributesh konkrete mund ti sjellë unë asaj gjykate? Sigurisht që kam një vizion personal timin për rolin e Gjykatës Kushtetuese dhe për mënyrën sesi e shikoj rolin e saj. Por gjithashtu kam edhe të projektuar ne mëndjen time edhe një identikit të një gjyqtari kushtetues. Pra, si duhet të jetë ai? Do mundohem ti paraprij disa nga pyetjeve. Kam idenë se edhe për këtë që do të them gjatë platformës time, gjithsesi do të ketë dhe proces pyetjesh më prapa. Unë do të ndalem shkurtimisht në përgjigjen e këtyre pyetjeve që unë ja kam bërë vetes para se të vija tek ju.

Kandidatia Elsa Toska, parashtron përmbledhjen e platformës së saj, të cilën e ka me shkrim dhe një kopje të saj e ka depozituar në sekretarinë e Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani shprehet se do të bëja një pyetje të vetme. Në përmbledhje të prezantimit tuaj, nuk është se nuk iu qasët fare, por doja një përgjigje të natyrës së

kritikës. Pra, sipas mendimit tuaj, çfarë nuk ka bërë mirë Gjykata Kushtetuese deri më sot, duke bërë një kritike ewventuale nga ju duke qenë dhe nga brenda saj, jo vetëm nga jashtë. Pra, cilat kanë qenë arsyet dhe si mund të ndreqen? Kush janë disa nga aspektet kushtetuese në të cilat ajo Gjykatë, sipas gjykimit tuaj, nuk ka bërë atë që pritet të bëjë Gjykata Kushtetuese dhe si mendon që mund të riparohet kjo gjë?

Kandidatja Elsa Toska, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se në kuptimin tim, me aq sa kam lexuar dhe me aq sa e njoh, edhe Gjykatën Kushtetuese edhe modelet evropiane që më prezantohen, Gjykatat Kushtetuese mund të jenë me dy axhenda. Një axhendë minimaliste dhe një axhendë ambicioze, atë të aktivizimit gjyqësor themi ne. Në një axhendë minimaliste, Gjykata Kushtetuese nëpërmjet le të themi parimeve apo doktrinë (*nuk dëgjohet mirë disa fjalë*), le të themi nuk bëhemi legjislator pozitiv, krijohet edhe një lloj vetëpërmbajtje e tillë dhe që në disa raste edhe nuk e zgjidh themelin e çështjes. Ë, mban një axhendë le të themi minimalist, po flasim në parim. Ndërkohë që ka gjykata që janë më aktiviste, janë më ambicioze.

Ardian Dvorani, ndërhyr dhe shprehet se edhe në këtë prizëm doja tu pyesja, për atë që quhet ometimi kushtetues. Keni ndonjë ide?

Kandidatja Elsa Toska, vijon përgjigjen duke u shprehur se kjo është nga më të vështirat në fakt. Por faleminderit, që ma bëtë atë pyetje. Atëhere, kemi kategorinë e dy gjykatave kushtetuese. Pra, modelet e dyta, “Sadurski” e shtjellon në librin e vetë, për aksesin në Gjykatën Kushtetuese në vendet post komuniste, meqënëse janë gjykata më aktiviste. Pra, janë më abicioze le të themi. Le të çojmë përpara jurisprudencën, mbase shtjellojnë dhe doktrina që nuk janë cekur shumë, çojnë më përpara standartet, kanë një lloj guximi më të lartë, për tu përgjigjur pyetjeve kushtetuese që i shtrohen. Në këto dy qasje unë mendoj që në vende si tonat, me problematikat që ne kemi si vënd post komunist, me një sistem demokratik jo aq të konsoliduar, me element tepër të ndjeshëm të natyrës publike dhe politike që na shqjetësojnë të gjithëve, e që në fakt na shqjetësojnë edhe si profesionist, edhe si qytetar, edhe si familjar, mendoj që gjykatat kushtetuese të Europës Juglindore ,duke përfshirë këtu edhe Gjykatën Kushtetuese Shqiptare, në momente të caktuara duhet të kishim qënë më aktive për tu dhënë përgjigje pyetjeve kushtetuese ashtu siç u janë shtruar. Për këto poblematika komplekse mund të ketë teknika nga më të ndryshme dhe ato mund të kenë strategji nga më të ndryshme për tu shmangur nëpërmjet aksesit, juridiksionit, legjitimitimit. Ka shumë elementë. Por, për mua thelbi është që në një demokraci kushtetuese, kontrolli gjyqësor dhe kostitucionalizmi janë ato që thonë fjalën e fundit. Dhe për sa kohë, kjo është qasje personale tani, përsa kohë që vjen një konflikt thelbësor, do ti përgjigjesh thelbit të konfliktit dhe nuk ka konflikt të natyrës sociale, ekonomike, politike, që nuk prek edhe standartet kushtetuese dhe ligjore, shumë pak mund të ketë. Në kushtet që të vjen dhe të shtrohet si pyetje

kushtetuese, mendoj që duhet ti kthehet një përgjigje kushtetuese për thelbin. Mbase nuk u përgjigja 100% por mund të them që mund të bëheshin ca gjëra më mirë, në këtë kuptim, pra, të të qënit një gjykatë më aktive. Mund të bëheshin ca gjëra në qëndrueshmërinë e vendimarrjes. Ne mund të bëhenim ca gjëra më mirë edhe në arsyetimin e qartë të vendimeve sepse vetë ne jemi koshient që herë pas here tek gjyqësori i zakonshëm kemi sjellë problematika sepse nga vendimarrja jonë gjyqësorit të zakonshëm i kanë lindur probleme se si ta kuptoj vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Sigurisht që kjo nuk është gjë e mirë, mendoj. Duhet të jemi më të kujdesshëm në këto elementë, në elementët e arsyetimit.

Fatjona Memçaj merr fjalën dhe shtron pyetjen se në cilat nga situatat jeni gjendur ju konkretisht, nga cilat lloje çështjesh gjykoni dhe se si ka spikatur aftësia juaj për të marrë përsipër përgjegjësinë.

Kandidatja Elsa Toska, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se unë mendoj që si këshilltare ligjore i kam marrë 100% përgjegjësitë e mia në atë gjykatë. Kam qenë këshilltare ligjore në cilësinë e një këshilltare që kam punuar direkt me dosjet dhe po them në 95% të rasteve unë kam dalë me konkluzion përfundimtarë për çështjen. Në kuptimin që kam pasur kurajon për të thënë drejtpërdrejt perspektivën time për çështje konkrete a pranohet apo refuzohet kërkesa. Kam qenë e gatshme le të themi të jap një orientim apo një drejtim çështjes përkatëse. Sigurisht, kam pasur dhe një përqindje që nuk e kam bërë këtë gjë, por jo nga mungesa e marrjes përsipër e përgjegjësiave, as nga mungesa e kurajës. Por sepse ne aty japim opinionet para se të zhvillohet seanca gjyqësore dhe më është dashur sigurisht që mendime të caktuara ti konsolidoj pasi të dëgjoja dhe palët në seancë ose kam pasur raste të them të vërtetën që edhe vetë mund të kem qenë e dyzuar dhe kam qenë ndërmjet dy mendimeve dhe këtë e kam shprehur dhe brenda opinionit. Pra, që mund të jem pro situatës për 1, 2, 3 argumenta, por mundet të jem edhe kundër situatës për 1, 2, 3, 4 argumenta. Kështu mendoj që përgjegjësi si këshilltare ligjore aty, në kuptimin e çështjeve gjyqësore mendoj që i kam marrë të plota. Këtë detyre kam pasur unë, të bëja opinione ligjore dhe të dilja në konkluzione përkatëse për çështjen një gjë që nuk jam shpangur asnjëherë. Kurse nga pikëpamjet të elementeve të tjerë, se për përgjegjësitë në fakt, unë siç e mendoj unë, në vizionin tim, një funksionar publik ka përgjegjësi të natyrave të ndryshme edhe në mënyrën sesi performon në jetën e përditshme e profesional enë institucion, çfarë mesazhes jep më sjelljen e vet, me kulturën e vet të punës, si angazhohet në çështje të ndryshme të tjera më institucionin përkatës, çfarë kontributi jep përtej çëshjes gjyqësore. Unë mendoj që këtë e kam bërë. Mendoj që nuk kam rreshtur së dhëni mendime në Gjykatën Kushtetuese për gjëra që mund të ndryshohen nga pikëpamja e organizimit dhe funksionimit të brendshëm. Pra, në kapacitetin administrativ, kam qenë pjesë e grupeve të punës, pothuajse në çdo grupi pune që

është ndërtuar në Gjykatën Kushtetuese. Aty kontributet i kam pasur edhe të vlerësuara nga kolegë të ndryshëm po dhe nga gjykatës për cilësinë dhe shpejtësinë. Por sigurisht edhe në jetën time të përditshme unë mendoj që kam marrë përgjegjësi të plota, me atë se si e lexoj unë nga jashtë si këshilltare e Gjykatës Kushtetuese.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet që do të bëj të njëjtën pyetje që ia bëra edhe paraardhëses. Ju jeni nga këshilltarët që i jeni nënshtruar procesit të vlerësimit dhe verifikimit nga K.P.K-ja, kjo tregon në formë guximin për përballjen sepse ne jemi gjyqtar dhe e dime sesa e vështirë është ai si proces.. Unë kështu e lexoj në fakt. Në pjesën tjetër unë dua tju bëj një pyetje, ju i jeni nënshtruar një testimi në Shkollën e Magjistraturës. Doja të dija mendimin tuaj mbi rezultatet e këtij testimi dhe se si e shikoni atë testim në raport me vlerësimin tuaj, qoftë sa do pak profesional.

Kandidatja Elsa Toska, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se në fakt e çmoj si pyetje sepse është një çështje që më ka përndjekur dhe dua ta jap këtë sqarim. Në aty ju nënshtruam si këshilltare ligjore dhe testimi u bë mbi bazën e dy llojeve të testeve. Ishte testi i përgjithshëm nga i cili duhet të kalonim 100 pikë, më falni kishte maksimalisht 100 pikë, dhe duhet të merrje 60, që të quheshe kaluese. Dhe testimi i dytë ishte i një natyre më profesionale, në bazë të ekspertizës së këshilltarit që ishte prapë 100 pikë maksimumi dhe duhet të kaloje mbi 60% të provimit. Në testin e parë, unë nuk arrita të marr 60 pikë, mora 57 pikë. Humba për 3 pikë, për tu bërë kaluese në këtë testin e parë. Në testin e dytë, unë mora 156 pikë nga 200 të mundshme që i bie në një matematike 75 % ose 80 %. Pra, kalova më shumë sesa 60%, tek testi profesional. Që në fillim, kur u vumë në dijeni që do të nënshtroheshim këtij lloj testi, më aq sa kam mundur, kam shprehur opinionet dhe mendimet e mia, pavarësisht se nuk u dëgjova ose opinionet e mia personale nuk arritën të mbushin mendjen vendimarrësve në këtë lloj provimi. Por kam qenë me idenë që në atë provim këshilltarët e Gjykatës Kushtetuese, të cilët nuk kishin ambicie për ti hyrë Shkollës së Magjistraturës, nuk kishin përse ti nënshtroheshin të dyja testeve. Ishte shumë e thjeshtë që Shkolla e Magjistraturës ti ndante këshilltarët në dy kategori. Tu kërkonte kategorisë me ambicie për tu bërë pjesë e gjyqësorit të zakonshëm, doni nuk doni, dhe ti nënshtroheshin edhe testit të parë. Kategorisë tjetër, ku bëj pjesë edhe vetë, pra, që nuk kisha ndonjë ambicie për të hyrë në Shkollën e Magjistraturës, ti nënshtroheshim vetëm testit të dytë. Kjo gjë nuk u bë. Pra, pavarërisht vullnetit tonë personal dhe pavarësisht standardit ligjor sipas ligjit për rivlerësimin kalimtar i cili nuk flet për dy teste, thotë: aftësimi profesional vërtetohet përveç relacioneve, opinioneve, i jep rëndësinë maksimale ku thotë edhe nëpërmjet një provimi të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në të cilën duhet të kaloj 60 % të testit. Unë mendoj, që unë mbi 60% të testit, 80 % të testit, në provimin e magjistraturës, e kalova dhe madje e kalova me shumë sukses.

Ju vetë mbase e keni bërë atë provim. Nuk e di. Hyn tek provimet jashtë mase të vështira. Në nivel personal nuk kam aspak turp ta them, jam gozhduar për 5 javë nga mëngjezi në darkë. Është hera e parë që nuk arrita dot të kap atë lloj testi dhe që mendoj që nuk duhet të kisha hyrë fare në atë lloj testi. Në kuptimin tim asgjë nuk vlerësohet nëpërmjet mosmarrjes së atyre 3 pikëve në atë lloj testi. Ky është vlerësimi im personal. Nuk vlerësohet aspak profesionalizmi im me atë lloj testi. Më falni, unë thashë faleminderit për pyetjen sepse kjo është një pyetje që edhe na ka përndjekur pak....

Margarita Buhali, ndërhyr dhe shprehet se sa për sqarim, këtë pyetje ia kam bërë edhe kandidatës paraardhëse për të qenë në të njëjtin standard. Domethënë, që edhe ne të jemi transparent dhe bilës më mirë që ju dëgjuam për këtë pjesë, opinionin tuaj se sa thjesht ta kishim si një gjë të ditur por pa marrë mendimin e kandidatit. Veç veprimtarisë që keni bërë në mënyrë permanente tek Gjykata Kushtetuese dhe me të drejtë e thatë 12 vjet, nuk ju diskutojmë edhe për botimet për pjesën tuaj. Keni pasur një periudhë kohe pranë Avokatit të Popullit. Unë do të pyesja se cila është ajo veprimtari konkrete, dalluese e spikatur, që ju keni bërë gjatë atyre viteve të paktën nga viti 2000 deri në 2005, trajtim ankesash, paraqitje dhe mbrojtje, kërkesa për shfuqizimin në Gjykatën Kushtetuese, në atë periudhë? Aq sa ju mbani mend sepse është edhe një kohë e largët.

Kandidatja Elsa Toska, duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se që të isha e spikatur që në ditën e parë të punës, ka shumë pak gjasa të ndodhi tek Avokati i Popullit sepse isha në vitin e parë të punës. Por, unë mendoj që potencialin për të qenë e spikatur në atë institucion arrita ta tregoj. Tani mund të flasim për statistikën dhe mund të them që jam një nga personat që në vitin e dytë të punës, nëse një institucion ka një historik, këtë dhe mund ta gjej. Kam qenë nga ndihmës komisionerët që kam mbajtur një peshë të konsiderueshme punë. Nëse aty mund të kishte rreth 1500 çështje në vit, i binte ne kemi qenë në ato vite me 5 komisioner. Në vlerësimin tim, kapacitetet shkonin nga 300 deri në 500 çështje në vit për komisioner. Unë kam qenë nga ndihmës komisionerët me ngarkesën më të lartë të çështjeve në atë institucion. Po ti referohet institucioni historikut mund ta gjej këtë gjë, për sa çështje kam shqyrtuar unë në ato vite. Aty ka pasur një sistem online – dokulive, që i rregjistronte. Pra, ishte një intranet i brendshëm që mund të dalin shumë thjesht se sa ngarkesë pune kam mbajtur në atë institucion dhe nuk besoj që e kam mbajtur pa shkak. Besoj që kam treguar vullnet të jashtëzakonshëm. Kam treguar dëshirë për të punuar dhe kam treguar cilësi, cilësi profesionale. Komisioneri që më shpërndante punën sigurisht që ruante edhe balancën, por shikonte edhe peshën që mbante secili prej nesh dhe kapacitetin që kishte për të përballuar punën. Këtë mund të them. Ndërsa përsa i përket një elementi tjetër që edhe këtë dua të theksoj, është se në ato vite, nga Avokati i Popullit janë dërguar shumë kërkesa

në Gjykatën Kushtetuese dhe unë kam qënë një nga ata persona ku përfshiheshim në një grup pune minimalist, gati 3 veta maksimumi, si dhe vetë Avokati i Popullit ose vetë Komisioneri, sepse ashtu ishte ndarë puna. Dhe unë kam qënë gjithmonë një ndër ato 3 persona që investohesha në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut apo për argumente të çfarë do lloj natyre për të përgatitur çështjen për në Gjykatën Kushtetuese. Dhe e fundit fare, le të themi cilësia e punës si ndihmës komisionere tek Avokati i Popullit matej nëpërmjet rekomandimeve. Të paktën në ato vite kështu ka qënë. Pra, në fund të vitit, kur bëheshin vlerësimet për çdo person llogaritej se sa çështje ka mbajtur dhe në sa nga këto çështje ka dalë me rekomandime. Pra, me rekomandime, kuptohemi, bëhej fjalë nëse ishte konstatuar shkelja dhe ishte dalë me rekomandim që shkelja duhet të ishte vënë në vënd. Pra, kemi bërë një punë shumë serioze sepse ankesa mund të mbyllej edhe thjesht kur nuk ka shkelje, mund të mbyllej si jashtë juridiksionit, kishte disa mënyra sesi duhej të mbyllej një ankesë. Ankesa që mbyllej me rekomandim ishte cilësi pune dhe tregonte që ishe një punonjëse e spikatur për institucionin.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani pasi vëren se nuk ka pyetje te tjera, orienton vijimin e intervistës, në pjesën e dytë të saj, lidhur me vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja. Ekspertja Dr. Adelina Albrahimi ftohet të marrë fjalën dhe të zhvillojë bisedën për aq sa ajo e vlerëson të arsyeshme lidhur me pjesën e njohurive të gjuhës se huaj.

Ekspertja Dr. Adelina Albrahimi zhvillon bisedën e lirë dhe me pyetje përgjigje me kandidaten Elsa Toska në gjuhën angleze (Intervista zgjati 6 minuta).

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani në përfundim të pjesës së intervistës në gjuhën angleze, e njofton kandidaten Elsa Toska për përfundimin e intervistës duke falënderuar jo prezantimin

Thirret kandidatja Fiona Papajorgji për zhvillimin e intervistës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidaten Fiona Papajorgji se sot kemi ushtrimin e intervistës me ju sipas procedurave dhe kërkesave që parashikon ligji. Pra, në kuadër të vlerësimit profesional të kandidatëve është edhe pjesa e bisedës apo e intervistës, siç e quan ligji, ndërmjet kandidatëve dhe Këshillit, e cila është e strukturuar në dy pjesë. Pjesa e parë me dy2 nënndarje. Pjesa e parë është parashtrimi juaj i lirë lidhur me motivimin e kandidimit, i cili, nëse ju keni edhe përgatitur me shkrim, platformën, motivimin tuaj mund ta parashtroni në mënyrë të përmbledhur ashtu si mendoni ju se kush janë momentet më të rëndësishme apo elementet më të rëndësishëm. Pastaj do të pasohet me pyetjet e anëtarëve të Këshillit dhe përgjigjet tuaja. Dhe pjesa e tretë do të ishte pjesa zotërimi i gjuhëve të huaja. Këshilli vlerësoi që në rastin tuaj kjo nuk është e nevojshme, pasi gjuha Italiane që ju preferoni është një gjuhë me të cilin, ky ka qënë motivi, jeni shkolluar dhe keni punuar në profesion për shumë vite në Itali.

Pyetja e parë që do tu bëja, përbërjen e Këshillit ju e njihni besoj? Krahas nesh dhe sikurse ju e dini është edhe e Avokati i Popullit, zonja Ballanca që është pjesëmarrëse e përhershme në çdo lloj veprimtarie dhe në mbledhje të Këshillit. Janë edhe subjekte që ftohen në mbledhjen e Këshillit. Në mbledhjen e sotme është i pranishëm zoti Bledar Dervishaj, që është këshilltari i Presidentit të Republikës. Në dijeninë tuaj, jeni në gjendje papajtueshmërie apo konflikti i interesit me ndonjërin prej nesh, pjesëmarrës në mbledhje ose jo?

Kandidatja Fiona Papajorgji, përgjigjet se, duke falënderuar në radhë të parë për këtë moment që do të ndajmë bashkë. Për sa i përket pyetjes nuk mendoj se kam ose gjëndem në konflikt interesi me ndonjërin prej anëtarëve apo pjesëmarrësve të tjerë në këtë intervistë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani fton kandidaten të vijojë me parashtrimin e lirë të motivimit të kandidimit.

Kandidatja Fiona Papajorgji, duke falënderuar edhe njëherë, parashtron se Për sa i përket arsyeve të kandidimit ose motivimit, Ju tashmë keni, dispononi gjithë materialin që unë kam depozituar së bashku me kërkesën. Ka qenë një nga sfidat e mia ky kandidim. Në çfarë kuptimi? Ishte ekperiencia për shumë vite si këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese që më bëri të mendoja se ishte momenti i duhur, pas një ekperiencë të gjatë të shqyrtimit të një sërë dosjesh, shqyrtim jo vetëm i dosjeve pranë gjyqtarit që unë kam punuar. Në fillim secili këshilltar i Gjykatës Kushtetuese punonte i atashuar vetëm me njërin prej gjyqtarëve, por i parë në 360 gradë, në kuptimin e të gjithë dosjeve. sepse kemi pasur për të bërë jo vetëm opinione dhe relacionet e dosjeve që na përkisnin, por edhe opinione e mendime pakicë dhe shumicë për shumë dosje të tjera. Dhe mendoj se kam arritur një ekperiencë të duhur, po e lëmë mënjatë pjesën e plotësisht të kushteve të kërkuara nga ligji, se tashmë ato dihen nga vendimi i lejimit. Kuptohet që është e guximshme të thuash që kam gjithë eksperiencën e duhur. Gjithë jeta nuk do të mjaftonte kurrë për të krijuar një ekperiencën sa më të duhur në një fushë të caktuar, qoftë edhe ajo kushtetuese që tashmë unë jam më e angazhuar, por gjithsesi kjo më pëlqente dhe kjo ishte një nga arsyet kandidimit. Për sa i përket platformës personale. Ju tashmë atë e dispononi, sepse unë e kam depozituar që në fillim me dokumentet e mia dhe çfarë synoj apo çfarë po më vinte edhe në mendje apo përpara se të hyja në intervistë, ishte që një nga gjërat, një nga sfidat kryesore që do të kishte në kohët e tanishme Gjykata Kushtetuese, të qënurit një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, është arritja e paqes sociale.

Kandidatja Fiona Papajorgji, parashtron përmbledhjen e platformës së saj, të cilën e ka me shkrim dhe një kopje të saj e ka depozituar në sekretarinë e Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani orienton kandidaten që, duke menduar se koha nuk është e pakufizuar nëse vlerëson të trajtojë edhe ndonjë moment tjetër që ka rëndësi mund të vazhdojë. Ose të kalojmë në pyetjet e anëtarëve të Këshillit.

Kandidatja Fiona Papajorgji shprehet se si të dëshironi, mund të flas edhe më shumë. Unë bëra në mënyrë të përmbledhur parashtrimin e platformës personale. E gjitha pastaj është e shkruajtur me shkrim. Më mirë të kalojmë tek pyetjet.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, duke orientuar kalimin tek pyetjet e anëtarëve të Këshillit, shprehet se do tu bëja një pyetje që ia bëra edhe kolegës që ishte përpara jush. Çfarë mendoni se nuk është bërë mirë deri më sot apo nuk është bërë fare nga Gjykata Kushtetuese? Pra, ju e parashtruat, e cekët pak, por do ta doja të dëgjoja se çfarë kritike keni ju ndaj punës që ka bërë deri më sot Gjykata Kushtetuese?

Kandidatja Fiona Papajorgji përgjigjet se në fakt unë e thashë që në fillim Është pak e guximshme që të marrësh dhe të thuash kam njohuritë e plota apo jo mbi jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, absolutisht që atë të paktën pretendoj që e di. Por që ta shohësh edhe me një sy kritik. Ndoshta me kalimin e viteve mund të bëhen edhe disa kritika sepse jo gjithmonë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, qoftë mbi paanshmërinë e gjyqtarit kushtetues, ka qenë konstante. Ka pasur momente në të cilat, por ato janë rast pas rasti, por ka pasur disa momente në të cilat jurisprudenca, në mendimin tim modest, nuk ka qenë apo ka lënë vend për kritika ose ka lënë vend për dy standarde. Por duke qenë se punoj në atë gjykatë, me thënë të drejtën e theksoj që puna që është bërë, dhe këtë nuk e them për të mos bërë kritika gjykatës, nga puna e përditshme që është bërë ka pasur studime të thelluara mbi të gjitha çështjet dhe të flasësh për çështje që nuk mund të shihen me një sy kritik apo një vendim që nuk ka qenë jo shumë i mirë, sinqerisht që këtë nuk e marr përsipër ta bëj. Në momente të caktuara, të përcaktuara edhe nga rrethana të ndryshme, mund të ketë pasur vënd për diçka më të mirë. Gjithmonë ka vend për diçka më të mirë, por që të them mirë dhe jo shumë të mirë të Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të përcaktoj një edhe të vë gishtin një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, si të tillë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, ndërhyr dhe shprehet se unë e shtrova pyetjen jo lidhur me vendimet konkrete, sigurisht i bindemi dhe i përulemi çdo vendimi, por këtu është një qasje tjetër. Këtu është një bisedë dhe mund të jepet një pikëpamje ose mbi një problematikë që nuk është trajtuar apo është trajtuar jo aq sa duhet nga Gjykata Kushtetuese. Këtu e kisha qasjen. Më mirë të bëhëm pak më konkret. A mendoni ju që duhet të vijojë Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ti përkasi atij grupi të shkollave të gjykatave kushtetuese që nuk e pranojnë ometimin kushtetues, pra arsyetimin dhe disponimin për ometimin kushtetues apo duhet që ndoshta të

ndryshojë kurs edhe ti përkasi dhe një grupi të konsiderueshëm, nga njohuritë e mia modeste, të Gjykatave Kushtetuese Perendimore, të cilat e prekin goxha, aq sa di unë, këtë çështje?

Kandidatja Fiona Papajorgji përgjigjet se me sa mua më kujtohet, gjykata është ndalur edhe tek ometimi legjislativ. Sigurisht gjykata ka rolin e një ligjvënësi negativ, por unë nuk mund të marrë asnjëherë kompetencat e ligjvënësit dhe nuk mund të bëhet ligjvënës pozitiv. Unë të paktën vij në sistem me shkollim Italian, di që dhe jurisprudenca...

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, ndërhyr dhe shprehet se sapa doja tu pyesja, çfarë ndodh me konsultën Italiane?

Kandidatja Fiona Papajorgji përgjigjet se jurisprudenca Italiane ka shumë vendime mbi ometimin legjislativ, por tek ata edhe në mënyrën e vendimarrjes, për mënyrën se si ndahen vendimet, ato nuk janë thjesht vendime pranimi apo të rrëzimit të kërkesës. Apo nuk ndalen vetëm thjesht në një interpretim pajtues, në qoftë se do të futemi edhe në teknikën e interpretimit pajtues. Vendimet, ndoshta kjo kuptohet, një gjykatë kushtetuese me një eksperiencë mbi 50 vjeçare lë për të mësuar një gjykata më të re, siç është ajo e jona, dhe duke konsideruar mënyrën, tipologjinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese Italiane, ata kanë edhe vendime ku shpallin antikushtetuese ligjin në një pjesën kur nuk shprehin diçka apo në pjesët kur kanë të parashikuar diçka apo kur kanë për të parashikuar diçka e cila duhet të zëvendësohet me diçka tjetër. Ne nuk kemi arritur në këtë standard akoma. Sigurisht që unë atë prirje kam dhe më pëlqen dhe nuk mund ta mohoj këtë. Secili varet dhe nga mënyra e shkollimit dhe frymës që ka marrë, por e thashë edhe që në fillim, hapja ndaj vlerave të reja jo shprehimisht të përcaktuara nga Kushtetuta apo marrja e vendimarrjeve të reja kërkon shumë guxim, shumë guxim, pasi sjell komplet një ndryshim të jurisprudencës tonë. Po pse jo, në kemi bërë edhe një ndryshim edhe të jurisprudencës në 2010, të ndikuar nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, kështu që gjithmonë ka vënd, edhe për këtë rast pse jo.

Vitore Tusha, merr fjalën dhe shprehet se nuk dua të bëj pyetje por mund ta vazhdoje fjalinë edhe ta mbyllë argumentin, jo të gjithë e dinë se çfarë bëri gjykata në 2010?

Kandidatja Fiona Papajorgji përgjigjet se në vitin 2010, vendimi nr.30 i vitit 2010, jo të gjithë vendimet në fakt mbahen mend me nr. sepse tani është shtuar vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese, por ai të paktën më kujtohet. Ndryshoi mënyra, jurisprudenca dhe interpretimi mbi avokatin e caktuar kryesisht për të pandehurin. Ideja ishte që, në qoftë se është avokati i caktuar kryesisht dhe bën rekursin për të pandehurin, kjo nuk do të thotë që ai ka marrë pëlqimin dhe vullnetin e vetë të pandehurit. E gjitha duhet të bazohet mbi vullnetin e shprehur të të pandehurit.

Vitore Tusha merr fjalën dhe shprehet se mjafton kjo përgjigje. Ka edhe vendime që lidhen me gjykimin përtej afatit, natyrën e gjykimit dhe të konstatimit që lidhet me këtë çështje?

Kandidatja Fiona Papajorgji përgjigjet se në fakt, përsa i përket kësaj, këtu ndoshta kritika mu kujtua tani në një aspekt, sepse jo gjithmonë të vijnë ato impulset në mendje direkt përsa i përket konstatimit sipas natyrës së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, më anë të të cilave thjesht ka konstatuar se nuk është respektuar afati i arsyeshëm dhe hyn në atë tipologjinë që unë thashë në fillim, vetëm të pranimit dhe të rrëzimit të kërkesës. Këtu do të kisha një sy kritik sepse në fund të fundit, gjykata veçse e ka konstatuar, ka mbetur thjesht në një konstatim dhe nuk ka sjellë në fund të fundit, me ndryshimet që janë bërë tani dhe në Kodin e Procedurës Civile kuptohet diçka do të ndryshojë, madje janë vendosur tashmë edhe masat e caktuara të dëmshpërblimit në rast të konstatimit të tyre. Por deri në jurisprudencën e deritanishme këto vendime kanë qenë thjesht deklarative dhe nuk kanë sjellë absolutisht asnjë pasojë tjetër përveçse natyrës deklarative.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se ju uroj suksese në radhë të parë. Dukeni edhe nga mënyra e prezantimit që keni punuar edhe avokate, pra keni qenë tek pjesa e praktikës. Unë doja tu bëja pak a shumë një pyetje që ia u kam bërë edhe kolegeve të tua të mëparshme. A keni pasur ndonjë rast që, nëpërmjet relacionit tuaj, keni pasur mendimin kundër nga ai i gjyqtarit pranë të cilit keni qëndruar dhe nëse po, si ka vijuar më tej dhe sa raste mund të kenë qenë të tilla? Flas gjithmonë në kuadër të mendimit tuaj të pavaruar dhe guximit për ta shfaqur këtë mendim dhe për ti mëshuar atij.

Kandidatja Fiona Papajorgji, duke e falenderuar për pyetjen, përgjigjet se për sa i përket eksperiencës time personale. Më rezulton se dosjet, e nga momenti i rregjistrimit në drejtorinë gjyqësore kalonin tek këshilltari i gjyqtarit të caktuar si relator. Në pjesën më të madhe, gjyqtari me të cilën unë punoja, nuk i kishte lexuar. Kështu që përgjegjësia e parë binte tek unë, që të bëja relacionin. Dhe e them këtë që nuk i kishte lexuar në çfarë kuptimi? Unë nuk kisha ndonjë ndikim në mënyrën se si do të bëja relacionit, pasi dosja vinte fizikisht tek këshilltari, në rastin konkret, tek unë për herë të parë. Kuptohet që në qoftë se kishte ndonjë dosje me ndonjë ndjeshmëri studimet bëheshin edhe paralelisht, nuk e përjashtoj absolutisht këtë. Në përqindjen më të madhe të rasteve, mund të them 90- 95 % të rasteve, dosja fizikisht kalonte personalisht tek unë. Nga momenti që më kalonte personalisht, kuptohet që unë relacionin e bëja sipas bindjes time mëse të lirë. Absolutisht, më garancinë më të madhe, sipas bindjes time të lirë. Ka pasur edhe raste në të cilat relacioni im nuk është ndjekur, në kuptimin që unë mund të kem vendosur ndryshe, mund të kem menduar jo të kem vendosur, sepse nuk kisha vendimmarrje dhe kompetencë vendimmarrjeje. Mendoja që çështja mund të kalonte për shqyrtim në seancë plenare. Kolegji mendonte të vendosej moskalimi i çështjes ose e kundërta. Ka pasur edhe raste kur gjyqtari më ka thirrur dhe më ka thënë pse është bërë ky relacion? Të paktën më jep arsye. Pastaj pasi kam dhënë arsyen më

ka thënë përse mendonte të kundërtën. Ka pasur raste kur kolegji ka vendosur sipas relacionit që është bërë nga këshilltari sikurse ka pasur edhe raste ndryshe.

Margarita Buhali merr fjalën dhe pyet ndonjë çështje konkrete e mbani mend e që ju ka ngelur në mendje për qëndrimin tuaj?

Kandidatja Fiona Papajorgji përgjigjet se çështje konkrete specifike jo, sepse kane qenë më tepër mbi individë. Mbi çështje ligji absolutisht nuk ka ndodhur ndonjëherë kjo gjë sepse normalisht në çështjet e ligjit ato që kanë qenë haptazi të pabazuar. Kështu që kalonin domosdosmërisht me moskalim në seancë plenare. Për të gjithë çështjet e tjera të ligji kërkohet një studim i thelluar me bashkëpunimin e gjyqtarit që ligji të paktën të kalojë për shqyrtim në seancë plenare. Është më mirë ti shikojnë të gjithë gjyqtarët sesa vetëm kolegji. Kështu që për ligjet nuk ka ndodhur kjo rast. Për individët kanë ndodhur, por nuk mund të kujtoj ndonjë rast specifik sepse është mbi individ dhe jo mbi ligj.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se kam pyetje tjetër. Kam parë vendimin tuaj nga K.P.K-ja. Ju jeni nga ato këshilltaret që kanë kaluar me sukses edhe provimin e magistraturës. Doja të dija, nga raporti i vlerësimit nga Inspektoriati që ju është bërë, mbase nuk u është njoftuar. Sepse në vendim merreshin pak a shumë me rezultat e vlerësimit të magistraturës dhe kjo ishte më shumë që ishte mëshuar. Në raportin që ju është njoftuar rezultati tuaj, a ka pasur diçka më shumë ?

Kandidatja Fiona Papajorgji përgjigjet se nga ana e K.L.D-së kam pasur një relacion rreth 25 faqe, i detajuar mbi të gjitha dosjet, mbi të gjitha gjetjet ku janë analizuar deri në jurisprudencë, edhe në atë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sa herë ishte aplikuar e zbatuar në rastin tim, si në dosjet e shortuara nga ana e K.P.K-së, ashtu edhe nga vetë opinionet që unë vetë kisha dorëzuar. Ndihem e keqardhur që në atë pjesë të vendimit të K.P.K-së është folur aq pak për anën profesionale. Nuk mund ta di arsyen. Por nuk e mendova të udhës ta ankimoja për këtë pjesë. Ja u them me sinjeritet këtë.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se nga që ju është bërë sepse nuk dilte tekvendimi që qenka bërë vlerësimi profesional nga K.L.D-ja dhe ishin marrë me këtë pjesë, ndërkohë që për kandidatët e tjerë ishte thënë e detajuar. Prandaj ua thashë dhe e vura në dukje. Edhe një pyetje të fundit, të lutem. Në vjetërsinë tuaj thuhet që keni mbajtur pozicionin e specialistes të nivelit të lartë pranë Drejtorisë së Kërkimeve, Studimeve, Botimeve të Gjykatës Kushtetuese për periudhën Mars 2009 – Maj 2011. Konkretisht, çfarë detyre, çfarë pune keni kryer? Cila ishte veprimtaria juaj konkrete dhe përse e vlerësoni, mbase kështu është e specifikuar e nivelit të lartë?

Kandidatja Fiona Papajorgji përgjigjet se si nivelit të lartë, është e tillë nga vetë kategoria e nënpunësve, gjithë specialistëve të Gjykatës Kushtetuese. Kështu e kemi në kontratën e punës. Përsa i përket veprimtarisë së kryer gjatë asaj periudhe. Drejtoria normalisht merret më të gjitha studimet mbi dosjet e rëndësishme që shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese më porosi të kryetarit apo të ndonjë gjyqtari apo të një grupi gjyqtarëve. Kryhen të gjitha studimet në fusha të ndryshme, sidomos në këndvështrimin krahasues, me gjithë legjislacionet dhe jurisprudencën e vendeve të tjera kryesisht atë gjermane, pse jo Italiane dhe kryesisht me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në periudhën, fatmirësisht e them këtë, në periudhën që unë kam qenë specialiste në atë drejtori, në gjykatë janë shqyrtuar çështje shumë të rëndësishme, siç ka qenë ajo e Lustracionit, Marrëveshjes Detare. Këto janë dy më të rëndësishmet që më vijnë në mendje, mbi të cilat kemi bërë një studim me të vërtetë shumë të rëndësishëm. Ato janë çështje mbi të cilën u angazhua jo vetëm drejtoria, por edhe të gjithë këshilltarët. Edhe në çështjen specifike “Xhera” që u rikthye nga Gjykata Evropiane, edhe mbi atë kemi bërë studim. Kishte shumë çështje dhe shumë studime përveç këtyr. Kryetari i gjykatës në atë periudhë caktonte, për parime të caktuara të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, grupe pune në të cilët edhe specialistët e Drejtorisë së Studimeve merrnin pjesë për të përcaktuar, për të pasur në një farë mënyre në bibliotekën e gjykatës parim pas parimi, studime të ndryshme mbi jurisprudencën e gjykatës. Pastaj, ok, ishte edhe pjesa e botimeve. Edhe botimi në vetvete duket ndonjëherë sikur është vetëm një pjesë manuale. Por, të bësh indeksin, të lexosh të gjithë jurisprudencën dhe ta bësh atë analitik sipas të gjithë kriterëve dhe standarteve, sigurisht që të ndihmonte në njohjen e jurisprudencës së gjykatës.

Fatjona Memçaj merr fjalën dhe shprehet se nuk na lejohet të bëjmë vlerësim mbi intervistën, por kryetar më lejoni të them se ishte intervista më pak e lodhshme sepse ka kaq kohë që jemi ketu. Kam një pyetje shume të shkurtër besoj. Në gjykimin tuaj çfarë ndodh që të mbani një angazhim të tillë siç është ai i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese që në themel të tij ka vendimmarrjen? Cilat janë ato cilësitë tuaja personale që ju i gjykoni se i keni dhe ju bëjnë të përshtatshme për këtë vend?

Kandidatja Fiona Papajorgji përgjigjet se cilësia personale kryesore është përvoja e gjatë në Gjykatën Kushtetuese, përgatitja e relacioneve, opinioneve, projekt-vendimeve janë baza, të paktën për të marrë njohuri mbi jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Kuptohet që vendimmarrja është një peshë tjetër. Por duke pasur njohuri shumë të mira mbi jurisprudencën, mbi mënyrën e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, qoftë edhe në ato raste kur ka qenë në trysni të madhe ndaj çështjeve të caktuara, duke pasur parasysh disa detaje ku ndonjëherë shtyhej diskutimi pasi të binte në një fare mënyre trysnia, këto janë ato eksperiencë që të japin në një farë mënyre të kuptosh rëndësinë e duhur për të marrë edhe këtë hap mbi vendimmarrjen. Kuptohet që

është një peshë e madhe ajo e vendimmarrjes që do të mësohet hap pas hapi dhe nuk mund të them e kam një eksperiencë mbi vendimmarrjen.

Arta Marku merr fjalën dhe shtron pyetjen se çfarë vështirësish mendoni se do ju presin nëse do zgjidheni anëtare e Gjykatës Kushtetuese, flas për vështirësitë e para nëse e keni menduar ndonjëherë një gjë të tillë?

Kandidatja Fiona Papajorgji përgjigjet se duke lënë mënjane ngarkesën tashmë të akumuluar, por që nuk mendoj se ngarkesa thjeshtë në numër është një problem e cila është një vështirësi por që superohet shumë shpejt, mjafton vullneti. Vështirësitë që me vërtetë mendoj se do të hasin gjyqtaret e Gjykatës Kushtetuese janë disa çështje konkrete të cilat tashmë Gjykata Kushtetuese duhet ti zgjidhë, mbi të cilat më thënë të drejtën, jo në të gjitha rastet kemi pasur jurisprudence, të cilat do të kërkojnë një studim shumë të thelluar. Dhe nëse e mendoj tani, për ato çështje që ndoshta të gjithë e dinë kush janë më të rëndësishme e që kanë ardhur në Gjykatën Kushtetuese, nuk mund të them si mund të merret një vendimmarrje. Këtë nuk e di pa një studim të thelluar. Kuptohet që kam një ide sepse kam edhe kam lexuar, por që vështirësia mendoj se do jetë shumë e madhe për ato çështje që janë vërtetë të rëndësishme për tu marrë vendim. Por me një studim të mirë çdo gjë do të arrihet.

Fatri Islamaj merr fjalën dhe shtron pyetjen se lidhur me këndvështrimin tuaj, për sa i përket vizionit për të ardhur në Gjykatën Kushtetuese, si një gjyqtare i Gjykatës Kushtetuese bashkë me kolege të tjerë dhe stafin menaxhues të gjykatës, çfarë do të përfshinit, në një paragraf të shkurtër ose fjali të gjatë, për të përkufizuar vizionin Gjykatës Kushtetuese të ardhshme? Cilat janë ato këto elemente të domosdoshëm që ju mendoni se nuk duhet të mungojnë, qofshin këto qëllime apo vlera?

Kandidatja Fiona Papajorgji përgjigjet se në fakt ato i përmenda në sfidat që do të gjendet gjyqtari kushtetues në kohët sotme dhe duke u ndalur edhe të vështirësitë që mu bënë tek pyetja paraardhëse, mendoj se janë disa sfida mjaft me rëndësi. E para dhe kryesorja që duhet të jetë vizioni. Mendoj se duhet të jetë vizioni i Gjykatës Kushtetuese në këtë kohë paanshmëria për çështjet shumë të rëndësishme në të cilat pushtetet me të vërtetë kanë shfaqur elemente konflikti ndërmjet njëra tjetrës. Pra për vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, gjëja e parë që më vjen ndër mend është paanshmëria e cila duhet të shfaqet dhe të jetë vizion pikërisht për të arritur besimin që duhet të kenë edhe qytetarët në radhë të parë tek drejtësia kushtetuese. Kështu që në një fjali të ngushtë është paanshmëria, pasi nëse do ndalemi në një fjali të gjatë kuptohet që janë shumë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, duke konstatuar se nuk ka më pyetje nga anëtarët e Këshillit, pasi e falënderon kandidaten Fiona Papajorgji për angazhimin dhe seriozitetin në

parashtrimin e motivimit dhe në përgjigjet e pyetjeve, ndërpret mbledhjen për një pushim të shkurtër.

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon me intervistimin e kandidatëve të tjerë për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, orienton vijimin e intervistave me kandidatet për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese dhe sipas kalendarit zhvillohet ajo me kandidaten Regleta Panajoti.

Thirret kandidatja Regleta Panajoti për zhvillimin e intervistës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidaten se ju e njihni besoj përbërjen Këshillit. Por, njëkohësisht, në mbledhje për shkak të përcaktimit kushtetues është edhe Avokati i Popullit që në këtë moment nuk ndodhet, por është duke hyrë se është pjesë e mbledhjes së sotme, si edhe përfaqësuesi i Presidentit, z. Bledar Dervishaj. Njëkohësisht meqenëse ligji parashikon edhe vlerësimin e njohurive nivelit të zotërimit të gjuhëve të juaja, për qëllimet e këtij procesi është e pranishme dhe po ushtron dhe detyrën e ekspertit znj. Adelina Ibrahimimi pedagoge e brendshme e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja që është në të majtën tuaj. Pyetja e parë që do tju bënim juve është nëse e shikoni tek ndonjëri prej nesh gjendje papajtueshmërie apo konflikti interesi me ju ?

Kandidatja Regleta Panajoti duke u përgjigjur shprehet se i nderuar z. Kryetar, të nderuar anëtarë, unë nuk shikoj asnjë konflikt interesi në përbërjen tuaj edhe me pjesëmarrësit e kësaj seance dëgjimore. Përveç kësaj dua tju falënderoj për mundësitë që më dhatë për të më dëgjuar. Bëhet fjalë për kohën e nxehtë, kohe pushimesh dhe është një ditë ngarkuar edhe me intervista dhe paraprakisht ju falënderoj.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se sidomos për gjyqtarët në muajin gusht, për juve është periudha më e mirë sepse është me ligj periudhë pushimi. Intervista ka dy pjesë. Në pjesën e parë është momenti që ju jeni e lirë të parashtroni motivimin tuaj të kandidimit. Sigurisht nuk duam tju shtrëngojmë në kohë por dua ta gjykoni edhe vetë kohën e arsyeshme që mendoni për të thënë në mënyrë të përmbledhur gjërat më të rëndësishme që kanë të bëjnë me motivimin e kandidimit tuaj. Pastaj do të vazhdojmë me pyetje edhe nga anëtarët e Këshillit, përgjigjet tuaja në lidhje me këto pyetje. Në pjesën tjetër, është pjesa e intervistës ose e bisedës që ju zhvillon me znj Adelina për sa i përket nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja. Tani jeni e lirë të parashtroni mendimet tuaja për motivet e kandidimit.

Kandidatja Regleta Panajoti merr fjalën dhe parashtron platformën e saj, të cilën pas parashtrimin e depozitoi me shkrim, duke u bërë pjesë e dosjes së kandidatës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se ju bëtë një parashtrim të përgjithshëm. Por ne ndoshta do tu ngacmojmë ose të paktën unë, pak më në detaje që lidhen me Gjykatën Kushtetuese. Si e shikoni ju në planin tuaj personal, jo vetëm si individ por edhe kjo është pjesë pyetjes, cilat janë pikat e forta të zgjedhjes së një gjyqtari karriere gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese dhe, bashkë me të çfarë kontributi të posaçëm do të jepte një gjyqtar apo disa gjyqtarë dhe gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese? Ku mendoni se duhet të jeni e kujdesshme dhe cila është pika e dobët, duke qenë gjyqtare për të kryer funksionin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese? Gjyqtarë quhemi të gjithë, por kemi disa dallime.

Kandidatja Regleta Panajoti merr fjalën dhe përgjigjet se nëse kuptova drejt pyetjen tuaj, Gjykata Kushtetuese është një nga gjykatat më të rëndësishme të sistemit tonë. Por një gjyqtar e ka për detyrë të punojë njësoj, qoftë në gjykatën e shkallës së parë, qoftë në gjykata më të larta. Problematikat që mund të ketë Gjykata Kushtetuese është fakti se për afër 1 vit e gjysëm apo 2 ne nuk kemi pasur Gjykata Kushtetuese funksionale. Prandaj, them unë, mund të jetë krijuar një ngarkesë në punë e cila duhet evaduar në mënyrë të menjëhershme dhe duhen gjetur zgjidhje sa më të mira sa më optimale, mbështetur edhe në paketën e re ligjore që së fundi ka kaluar parlamenti jone mbi organizimin, qoftë dhe në strukture dhe në performancën e Gjykatës Kushtetuese. Unë kam përballuar një ngarkesë jo të vogël në çështje gjyqësore në tematika të ndryshme, që nga çështjet e thjeshta civile e tregtare dhe kam gjykuar çështje penale. Prandaj them se mbaj në konsideratë faktin që kam zhvilluar rreth 9-10 seanca gjyqësore në ditë. Me një llogari të thjeshtë bie mbi 400 çështje të zgjidhura në themel në vit dhe për 20 vite këto janë shumë çështje. Unë them se kjo mënyrë e të organizuarit të punës sime është një pasuri ose një mundësi për të ditur e për të manovruar në kuptimin mirë të fjalës, me ngarkesën që është krijuar për shkak të mungesës së Gjykatës Kushtetuese. Lidhur me problematikat e shfaqura së fundmi është koha që Gjykatës Kushtetuese duhet të flasë, për të dëgjuar ato që duhet të dëgjojnë vendimmarrjet e tyre. Mënyra e të zgjidhurit të çështjeve në Gjykatën Kushtetuese të jete sa më efikase sa mëe thjeshtë për tu kuptuar nga të tretët, të cilët, herë pas here, kanë vënë pika mbi “i” mbi mungesën e kësaj gjykate. Nuk di nëse janë dobësitë e organizimit të brendshëm të saj sepse nuk i njoh dhe nuk kam qenë pjesë e Gjykatës Kushtetuese. Por di që ligji i ri për Gjykatën Kushtetuese, kaluar së fundmi në Parlament, krijon mundësitë e një ecurie normale të punës, krijon mundësinë e diskutimit ndërmjet kolegeve si dhe debatin në çështje gjyqësore për të arritur gjithmonë një rezultat sa më kualitativ. Unë i përkas atij brezi kur Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë takoheshin ndonjëherë me njeri tjetrin dhe shkëmbenin dhe mendime mbi çështjen që ato kishin për të zgjidhur dhe në dijeni time ky lloj takimi ka munguar. Nuk e di se sa e saktë jam në këtë konstatim timin, por qenia anëtare e Gjykatës Kushtetuese nuk të privon nga

kontakti ose nga mbledhjet e përbashkëta me atë të Gjykatës së Lartë ose me stafin Shkollës së Magjistraturës sepse i shërben edhe njëherë më mirë ecurisë se vendimmarrjes se kësaj gjykate. Por sigurisht që ka pasur mangësi sepse ne disa prej rasteve gjykatat ndërkombëtare kanë ndëshkuar vendimmarrjen gjyqësorit shqiptarë, flas në kuptimin që kanë gjetur shkelje të konventave ndërkombëtare në shumë prej vendime gjyqësore, qoftë në shkeljen e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe qoftë në zgjidhjen që u ka dhënë problemeve. Kjo pjesë e vendimmarrjes them se duhet të mëshirohet në zhvillimin e praktikës dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese unë kështu e mendoj se duhet të funksionojë Gjykata Kushtetuese.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shtron pyetjen së edhe pse në fakt është shkruar dhe në ligj, por përse mendoni se i nevojitet Gjykatës Kushtetuese te ketë gjyqtarë karriere?, perse është aq e domosdoshme te ketë gjyqtare karriere, është e dobishme apo e parëndësishme ?

Kandidatja Regleta Panajoti merr fjalën dhe përgjigjet se gjyqtaret e karrierës janë duke u treguar edhe pak modestë. Ata janë vlera te sistemit tonë gjyqësor që do të thotë se qenia e një gjyqtareje karriere ka formuar kornizën tende me te gjithë aftësitë dhe eksperiencat e tua, qe nga çështjet me te thjeshta deri në çështjet më të ndërlikuara dhe mos harroni se në Gjykatën e Tiranës janë gjykuar konflikte nga me delikatet dhe nga më të vështira ndoshta të gjyqësorit shqiptar. Kjo lloj eksperience e ndihmon gjyqtarin e karrierës për ta ndjerë veten me mirë edhe më të përshtatshëm në pozicionin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Unë pozicionin e gjyqtarit kushtetues e shikoj si privilegj dhe nder, që do të thotë se mbas shume viteve në gjyqësor, kam arritur të mësoj dhe nga gabimet e mia. Edhe gjyqtari ka raste kur nuk e justifikon me atë lloj vendimmarrje dhe zgjidhjen e konfliktit, por efekti qe ai ka pasur ne vijueshmërinë e karrierën e gjyqtarit është shumë i rëndësishëm se si unë kam reaguar dhe si unë jam rritur nëpërmjet gabimeve të mia. Gjyqtarin e karrierës ne e kemi shumë të nevojshëm, sidomos Shqipëria. Për mua, e thashë dhe njëherë, është privilegj që e fus veten në gjyqtaret e karrierës dhe kemi nevoje për gjyqtare dhe mendoj se edhe drejtimi i procesit gjyqësor ka të bëjë me faktin se ti ke fituar një eksperience për të menaxhuar debatin, provën edhe ligjin. Unë kështu e mendoj.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se duke qenë se jeni një gjyqtare ashtu siç e thatë ju e karrierës dhe që keni prekur me dorë jo thjesht leximin ligjit por zbatimin ligjit, pra jeni ajo që quhet ekspert i ligjeve në praktike. Dhe kjo e bën njohësin më të thellë për aq kohë sa vetë merr përsipër ta zbatojë. Unë do tju bëja një pyetje. Si e shikoni ju veprimtarinë Gjykatës Kushtetuese deri tani e cila nuk diskutohet që është pjese e mëtejshme e jurisprudencës sonë dhe e interpretimit të ligjit? Ku nuk shikon kushtetueshmerinë e tij në raport me atë që mendoni ju se duhet të ishte më mirë dhe ju mendoni se mund ta zgjidhni?

Kandidatja Regleta Panajoti merr fjalën dhe përgjigjet se unë ju falënderoj për pyetjen znj. Buhali. Ta shikosh Gjykatën Kushtetuese nga jashtë është e thjeshtë sepse mjafton të arrish te studiosh vendimmarrjet e tyre e të shikosh se sa ke ti mundësi të aplikosh si gjykatë e faktit. Por të jesh pjesë e Gjykatës Kushtetuese është pak më e vështirë. Çfarë do të bëja unë ndër 9 anëtare e Gjykatës Kushtetuese? Them se do të shpie në atë lloj gjykatë dinamiken e të shteruarit të gjerave. Kryesisht Gjykata Kushtetuese ka folur nëpërmjet vendimeve, nganjëherë te vështire për tu interpretuar dhe për tu kuptuar edhe nga ne që jemi njerëz të ligjit. Kur kemi marrë një vendim kushtetues e kemi lexuar disa herë për të arritur për të kuptuar atë çfarë kanë dashur të thotë ajo gjykatë. Imagjinoni çfarë ndodh ndoshta me subjektet, palët e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese. Çfarë do të bëja unë? Të arrija të shkruaj një vendim që se pari të zgjidhte konfliktin me përputhje me Kushtetutën dhe së dyti të ishte sa më thjeshtë e i kuptueshëm për palët që e lexojnë, por edhe për të tretët që orientohen në këtë lloj vendimmarrje dhe se fundi do mundohesha që interpretimi i Kushtetutës të ishte në mënyrë dinamike jo vetëm për rastin, por ti paraprinte rastit të radhës. Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj vendimmarrjet kryesisht për çështjet e pronave, edhe unë, edhe ju të nderuar njohim që legjislacioni jonë për pronat ka shkuar sa nga njeri kah ne tjetrin, duke mos dhënë asnjëherë zgjidhje përfundimtare çështjes. Eksperienca ime në shkallën e parë them se do të më japë mundësi që në rast se vjen për tu shqyrtuar një dispozite e kësaj pakete ligjore për pronat, do të mundohem ta shpjegoj dhe ti jap zgjidhje në atë mënyrë që Kushtetuta ti paraprijë rastit të radhës kur të vijë për tu gjykuar. Nuk e di nëse e morët përgjigjen.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se po të bëj unë edhe një pyetje tjetër. Kandidatët që janë në garë bashkë me ju, i pyetëm, në një këndvështrim tjetër duke qenë ato nga brenda gjykatës, për të dhënë një mendim nga çfarë është parashtruar në vizionin tuaj se çfarë shkon apo nuk shkon me Gjykatën Kushtetuese. Tani ju që jeni nga jashtë Gjykatës Kushtetuese dhe jeni gjyqtarë, mund të më thoni çfarë mendoni se janë problematikat të cilat Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë deri më sot nuk i ka trajtuar po mund ti trajtonte më mirë, më ndryshe apo nuk i ka trajtuar ashtu siç duhet? Cilat mendoni ju se janë sfidat e Gjykatës Kushtetuese për të ardhmen dhe nëse ka ndonjë gjë për ta riparuar ?

Kandidatja Regleta Panajoti merr fjalën dhe përgjigjet se unë e ndjej veten shumë të vogël të vlerësoj a ka punuar mirë Gjykata Kushtetuese.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se zëreni se jeni sot gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, kështu që konsideroheni se jeni “e madhe”?

Kandidatja Regleta Panajoti merr fjalën dhe përgjigjet se për mua Gjykata Kushtetuese ka folur sa herë që i është dashur të flasi. Por them se duhet të flasë pak më qartë në kuptimin që

kur vjen për tu shtjelluar, sqaruar apo për tu zgjedhur një konflikt duhet të flasë në mënyrë shteruese, në kuptimin që do të ezaurohet njëherë e mirë kjo lloj problematike që i është shtruar Gjykatës Kushtetuese. Sfidat sigurisht që janë të forta, sepse mos harroni për 2 vjet është vënë në diskutim a është e rëndësishme ekzistenca e Gjykatës Kushtetuese, a është apo a duhet që Gjykata Kushtetuese të ekzistojë në një vend evropian sic është Shqipëria e që sot është kandidat , ndërsa nesër mund të hapen shumë shpejt negociatat për tu bërë anëtare e BE. Nëse nuk flet gjyqësori në rangun e Gjykatës Kushtetuese në mënyrë të qartë dhe të prerë nuk do të arrijmë dot të rregullojmë pjesën tjetër të sistemit tone gjyqësore. Prandaj sytë dhe mendja janë tek Gjykata Kushtetuese për momentin sepse çështje që shtrohen për diskutim pranë saj janë te asaj natyre që kanë impakt shumë të madh jo vetëm për gjyqësorin, individin por edhe për shtetin, ekzistencën e tij dhe që është momenti kur duhet të dëgjohet zëri i Gjykatës Kushtetuese. A do dëgjohet me ndihmën time apo me pjesëmarrjen e kolegëve të tjerë këtë nuk arrij ta përcaktoj unë. Por nëse unë do jem anëtare e Gjykatës Kushtetuese nuk e di nëse do të bëj më mirë por do të përpiqem të bëj sa më mirë detyrim time për të interpretuar Kushtetutën, për të sjellë në unison ligjet tona qofte me Kushtetutën, qoftë me konventa ndërkombëtare ku ne i kemi ratifikuar dhe jemi bërë pjesë e tyre. Nëse doni detaje të jeni të sigurtë që nga gjyqtari i shkallës së parë sfida më e lartë dhe më e fuqishme është sfida me veten, pastaj është sfida për sistemin. Unë e ndjej veten vërtetë mirë për sa kohë që erdhi ky moment që gjyqësori shqiptar të ketë kandidatët e vetë për gjykatat më të larta. Ka qenë një nga mundësitë më të pabesueshme deri para një periudhe prej 6 muajsh, ndoshta para një viti që kur unë aplikova për kandidate për Gjykatën Kushtetuese. Më dukej në pamundësi absolute për të qenë unë një nga kandidatë nga ata që vijnë nga gjyqtarët e karrierës. Kjo ditë ka ardhur në sistemin gjyqësor shqiptar dhe them se duhet të këëë zërin e fuqishëm në Gjykatën Kushtetuese për ti dhënë zgjidhje problemeve.

Vitore Tusha merr fjalën dhe shprehet se duke e ditur që gjyqtari i gjykatës së sistemit gjyqësor po themi e kanë edhe një pikë takimi, se në fakt kanë shumë pika takimi me Gjykatën Kushtetuese, dhe kjo kontrolli incidental. A ju ka ndodhur në praktikën tuaj të gjykimeve për kaq vite, të paktën pas vitit 1998 që të keni dyshime mbi kushtetutshmërinë e një ligji dhe këtë dyshim mbi kushtetutshmërinë e një ligji ta keni shprehur përmes vendimmarrjes dhe kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese?

Kandidatja Regleta Panajoti përgjigjet se në mënyrë individuale unë nuk kam parashtruar ndonjëherë qëndrimin tim para Gjykatës Kushtetuese, por unë kam qenë pjesë e gjyqtarëve të Dhomës Penale të Gjykatës Tiranës që kanë sjellë pranë Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimin e dispozitave të Kodit Penal mbi ndëshkimin penal të ushtrimit të lotarive të palicencuara dhe ai lloj konflikti iu parashtrua Gjykatës Kushtetuese e cila e shfuqizoi dispozitën,

pra përfshirjen në ligj të zakonshëm të një vepre penale. Ky është ndër rastet që arrij të kujtoj, por më ndjeni ndoshta do të kem pasur një rast tjetër, por këtë rast arrij të kujtoj dhe e di që është shfuqizuar. Ka qenë debat se vinin për tu gjykuar kryesisht me ndryshimet e një ligji që kaloi në parlamentin tonë ndoshta me një shumicë jo të kualifikuar.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani pasi vëren se nuk ka pyetje të tjera, orienton vijimin e intervistës, në pjesën e dytë të saj, lidhur me vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja. Ekspertja Dr. Adelina Albrahimi ftohet të marrë fjalën dhe të zhvillojë bisedën për aq sa ajo e vlerëson të arsyeshme lidhur me pjesën e njohurive të gjuhës së huaj.

Ekspertja Dr. Adelina Albrahimi zhvillon bisedën e lirë dhe me pyetje përgjigje me kandidaten Regleta Panajoti në gjuhën angleze (Intervista zgjati 6 minuta).

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani në përfundim të pjesës së intervistës në gjuhën angleze, e njofton kandidaten Regleta Panajoti për përfundimin e intervistës duke falënderuar jo prezantimin.

Kandidatja Regleta Panajoti shprehet se sërish ju falënderoj për durimin është ditë vështirë, ditë e gjatë, ju falënderoj për të gjitha çështjet që shtruat për diskutim, bëra maksimumin të jem sa më e drejtpërdrejtë pa ato dorashkat e fillimit, por që dua shumë që përgjigjet e mia të kenë justifikuar kandidaturën time.

Thirret kandidatja Marsida Xhaferllari për zhvillimin e intervistës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidaten Marsida Xhaferllari se jeni e fundit për ditën e sotme. Do të zhvillojmë pjesën e bisedës apo të intervistës si e parashikon ligji dhe që është pjesë e punës sonë për të realizuar vlerësimin e kandidateve. Ju e njihni përbërjen e Këshillit, si pyetje e parë për të vazhduar më tej se gjithashtu pjesëmarrës në mbledhje është edhe Avokati i Popullit, e cila për shkak të ligjit është pjesëmarrëse në mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit, është përfaqësuesi i Presidentit z. Bledar Dervishi si subjekt që ftohet sipas ligjit dhe për komponentin e vlerësimit të zotërimit të gjuhëve të huaja është znj. Adelina Ibrahim, pedagoge e brendshme e gjuhëve të huaja të Universitetit të Tiranës. Pyetja është, nëse e shikoni ose në gjykimin tuaj gjendeni ne me ju apo ju me ne në situatë papajtushmerie apo konflikt interesi ?

Kandidatja Marsida Xhaferllari shprehet se deklaroj që nuk kam asnjë situatë konflikti interesi as me anëtarët e KED dhe as me te ftuarit. Faleminderit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidaten Marsida Xhaferllari natyra bisedës është kjo. Biseda është e ndarë në dy komponentë. Pjesa e parë është parashtrimi i lirë nga ana juaj i motivimit të kandidimit, sigurisht që nuk dua të ndjeheni e kufizuar në kohë, e rëndësishme është që ju të përdorni kohën e arsyeshme që të parashtroni motivimin e kandidimit, elementet më të rëndësishëm që sipas jush mendoni që janë më të rëndësishme. Pastaj biseda

vazhdon me pyetjet e anëtareve të Këshillit dhe përgjigjet tuaja. Pjesa e tretë është pjesa e bisedës që ju zhvillon për zotërimin e gjuhëve të huaja.

Kandidatja Marsida Xhaferllari shprehet se së pari unë dëshiroj tju falënderoj për zhvillimin kësaj procedure. Sigurisht që bazohet edhe në rregullat që ju keni miratuar pasi shoh se juve me këtë procedurë i mundësoni vetë anëtarëve të KED, por edhe kandidatëve si mua në rastin konkret të na jepet mundësia që të ofroj të dhëna mbi aftësitë e mia profesionale, mbi motivin për të cilin kam paraqitur kërkesë për kandidim dhe që kandidoj për këtë pozicion shtetëror dhe sinqerisht ju them faleminderit për këtë procedurë. Shpresoj të ecë sa më mirë. Se dyti i përgjigjem thirrjes ruaj për të qenë efektive. E kuptoj që jam e fundit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se të qenit e fundit në intervistë nuk lidhje fare me orientimin e dhënë.

Kandidatja Marsida Xhaferllari shprehet se edhe mua më intereson të jem efektive. E kuptoj dhe vështirësinë tuaj se është procedure që e ndiqni për herë të parë dhe kuptoj edhe lodhjen dhe angazhimin që secili prej jush ka pasur në këtë procedurë. Sigurisht që serioziteti i procedurës kërkon që të ndiqen të gjitha gjërat në detaje dhe me rigozitet. Do të përpiqem që të jem në mënyrë sintetike, sa më e përmbledhur dhe me bindjen që secili anëtar i KED tashmë është i njohur me detajet e plota të platformës që unë kam paraqitur për kandidimin në pozicionin e anëtares së Gjykatës Kushtetuese. Kështu që dëshiroj vetëm të theksoj ato gjëra që unë mendoj se janë realisht të rëndësishme që të dëgjoni në këtë seancë para se të kalojmë tek pyetjet. Unë në fakt e kam strukturuar këtë prezantim të sotëm, ashtu siç e keni parashikuar në piken 17 të vendimit nr. 5 të Këshillit, ku keni vendosur 4 komponentë ku kërkonit që kandidati bën me dije motivimin, cilat janë arsytet që e kanë bërë të kandidojë në këtë lloj pozicioni, të parashtrij objektivat që ai synon të ndjekë, të japë të dhëna për aftësitë e veta profesionale dhe cilësitë morale.

Kandidatja Marsida Xhaferllari parashtron në mënyrë të përmbledhur platformën e saj, kopja me shkrim e së cilës është e depozituar në dosjen e saj.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, duke falënderuar kandidaten për parashtrimin, shtron pyetjen se në këndvështrimin tuaj çfarë mendoni se nuk ka bërë apo nuk ka bere mirë Gjykata Kushtetuese deri me sot dhe që nëse ju do të jeni gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese mendoni se duhet të ndryshojë apo duhet të ndreqet në të ardhmen?

Kandidatja Marsida Xhaferllari duke falënderuar për pyetjen, përgjigjet se unë mendoj, i përkas atij grupi që mendojnë se në mozaikun e organeve të sistemit të drejtësisë, duke përfshire edhe Gjykatën Kushtetuese, megjithëse ajo nuk është tipikisht brenda pushtetit gjyqësorë, besoj që ai ka qenë një institucion i cili ka pasur performancën më të mirë. Megjithatë unë nuk jam e

kënaqur me çfarë ka qenë Gjykata Kushtetuese. Dhe jam lumtur që u bë reforma kushtetuese e vitit 2016. Pa dyshim që ka një grup gjërash që mund të bëhen më mirë dhe ato janë materializuar tashmë tek ndryshimet kushtetuese. Nëse unë do të lë jashtë grupin e çështjeve që është rregulluar tashmë me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore që kanë të bëjnë me masën e ankimit individual, me ndërmjetësimin e procedurave, opinionet këshillimore që mund të merren në Gjykatën e Strasburgut apo në organizmat tjerë ndërkombëtare, unë mund të them dy tre gjera praktike. Besoj se ndonëse duken gjëra të vogla, dua ta bëj si parantezë këtë unë besoj tek gjërat e vogla, besoj që gjërat e vogla dhe hapa të vegjël të qëndrueshëm japin një rezultat shumë më të mirë dhe të sigurtë sesa ndryshimet e mëdha. Dhe në këtë perspektivë unë besoj se shpejtësia në gjykim duhet të jetë një çështje në fokus të Gjykatës Kushtetuese. Pra, shpejtësia në marrjen e vendimit, në kuptimin e për më tepër që Kushtetuta dhe ligji tashmë i ka dhënë Gjykatës Kushtetuese edhe atributin që të shqyrtojë ankesa për zvarritje. Pra Gjykata Kushtetuese duhet të jetë një institucion që vepron me forcën e shembullit dhe duhet të jetë vetë në pararojë të këtij modeli. Një çështje tjetër që unë mendoj që duhet përmirësuar është cilësia e vendimeve. Cilësia e vendimeve dhe kjo duke marrë frymëzimin nga reforma e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Ato që janë marrë me këtë çështje besoj i kanë lexuar deklaratat e reformave. P.sh kujtoj këtu deklaratën e Kopenhagenit ku trajtohet cilësia e vendimeve të Gjykatës Evropiane. Po e bëj për analogji këtë dhe duhet të jete një çështje që të mbahet në konsideratë nga Gjykata Kushtetuese, në terma të qartësisë dhe konsistencës. Pra, meqenëse grupi i vendimeve që prodhon Gjykata Kushtetuese do të jetë një udhërrëfyes, kuadër, për organet shtetërore se si ta ushtrojnë veprimtarinë tyre, besoj që duhet të ketë një vëmendje të shtuar tek cilësia vendimit. Dhe e fundit unë kam nxjerr ca statistika të Gjykatës Kushtetuese, të publikuar në faqen e saj zyrtare, dhe me del nëse do ta krahasoj periudhën që kur filloi të funksiononte nga 92-shi deri aktualisht, sikur ka një rritje të numrit të çështjeve për të cilat Gjykata Kushtetuese shprehet me vendim përfundimtar. Ka edhe një rritje shqetësuese të rasteve që Gjykata Kushtetuese vendos mospranim. Nëse ne do ti bëjmë një analize makro kësaj, unë mendoj se përmirësimi drejtësisë kushtetuese në Shqipëri nuk duhet të jetë një detyrë që i takon vetëm Gjykatës Kushtetuese, por duhet që i gjithë shteti të funksionojë që nga fushata e ndërgjegjësimit, që nga roli i Avokatit të Popullit, për të zgjidhur disa çështje që të mos shkojnë në Gjykatën Kushtetuese. Po pse jo edhe me trajnimin e kapaciteteve të avokateve se si hartohen kërkesat për në Gjykata Kushtetuese nga pikëpamja e kërkesave formale e deri tek trajnimi i kapaciteteve të vetë Gjykatës Kushtetuese që në fakt mund të mos ta themi trajnim por mund ta themi në tryeza të rrumbullakëta për përditësimin e njohurive dhe shkëmbim përvoja.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se duke iu uruar suksese në këtë kandidim, ju bëj një pyetje më konkrete. Ju e keni qenë Drejtore e Kodifikimit për periudhën shtator 2018 -

gusht 2011. Doja të dija më konkretisht cilat janë ato ligje që ju keni mbajtur peshën kryesore të kontributit tuaj si në formulimin e këtyre ligjeve dhe në mbrojtjen në komisionin e ligjeve.

Kandidatja Marsida Xhaferllari përgjigjet se nëse ju jeni të interesuar për një informacion më të detajuar e të saktë, unë mund ta sjell me shkrim brenda ditës së nesërme. Për qëllime të kësaj tryeze sot unë mund të them se puna e Drejtorit të Përgjithshëm të Kodifikimit është e ndarë në shtylla kryesore. E para ka të bëjë me hartimin legjislacionit që lidhet me sektorin drejtësisë ku përfshihen qoftë ligjet për organizimin e pushtetit gjyqësor dhe kur unë kam marrë detyrën ka qenë në fazat finale ose më saktë në fazën e hartimit të akteve nënligjore të ligjit Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor të vitit 2008. Kam marrë pjesë në hartimin ndryshimeve të ligjit për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë, ku iu përgjigjem ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008 për kufizimin e mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm, riparimin e hierarkisë së kush është prokuror më i lartë, e drejta e ankimit deri tek detyrimi i Prokurorit të Përgjithshëm nga pozitë informuese mbi gjendjen kriminalitet në pozitë raportuese për gjendjen kriminalitet në Kuvend. Kam marrë pjesë në reformën për shërbimin të provës, për masat alternative ku për herë të parë u krijua Zyra e Shërbimit të Provës në Shqipëri, ndonëse Kodi Penal është miratuar dhe ka hyrë në fuqi që në 1995. Kam marrë pjesë në reformën e shërbimit përmbartimor ku për herë të parë u fut sistemi me dy nivele, shërbimi përmbartimor privat dhe publik. Sigurisht që do veçoja në mënyrë specifike dhe ndjehem mirë për ato dy nisma sepse ishin me impakt për Shqipërinë, ishim pjesë të udhërrëfyesit për Shqipërinë në rrugën liberalizmit të vizave, bëhet fjalë për ligjin antimafie dhe për ligjin për marrëdhënie juridiksionale me autoritet e huaja në fushën penale. Këto dy ligje kanë mbajtur peshën kryesore dhe madje njërin prej tyre, ligjin antimafie e kam mbrojtur në Gjykatën Kushtetuese pasi u sfidua për çështje të një procesi të parregullt ligjor nga disa shoqata edhe të tjera po ...

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyr dhe shprehet se ju keni pasur edhe komponentin e përafrimit të legjislacionit, se po ndërhyj ...

Kandidatja Marsida Xhaferllari përgjigjet se padyshim që është edhe procesi i përafrimit të legjislacionit ..(ndërhyrje pa mikrofon). Juve keni me sa kuptoj nostalgji. Dmth procesi i hartimit të legjislacionit është një proces shumë kompleks. Fillon me hartimin e programit legjislativ që ndërtohet mbi bazë vjetore dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave. Detyra e Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit është edhe të sigurojë përjasjen e legjislacionit të hartuar me Kushtetutën, por edhe me legjislacionin në tërësi dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në këtë fushë është sidomos e fokusuar veprimtaria për dhënien e mendimeve për të gjitha nismat me karakter normativ që hartohen nga ministrat e linjes.

Margarita Buhali duke e falënderuar për qartësinë merr fjalën dhe shprehet se kam një pyetje tjetër e që ka të bëjë me punën tuaj si gjyqtare. Në CV-në tuaj është shënuar që ju keni mbajtur pozicionin e gjyqtares për periudhën 1999 -dhjetor 2007. Doja të dija në dhomën civile apo penale? Dhe për aq sa mundeni të na tregoni rëndësinë e çështjeve, karakterin, impaktin, sensibilitetin e çështjeve që ju keni gjykuar .

Kandidatja Marsida Xhaferllari përgjigjet se unë në Gjykatën e Rrethit Fier e kam filluar veprimtarinë që në vitin e tretë të Shkollës Magjistraturës, në vitin 1999 dhe pas diplomimit mora emërimin përfundimtar në detyrë të cilën e kam ushtruar deri në dhjetor të vitit 2007 kur pranova për të shërbyer në Ministrinë e Drejtësisë. Në vitin e parë, ashtu siç dhe ligji për Shkollën e Magjistraturës e parashikonte, jam angazhuar në çështje të thjeshta dhe kryetari i gjykatës më ka caktuar si pjesë të seksionit familjar. Jam marrë kryesisht me zgjidhje martesë, caktim kujdestarie, çështje të këtij niveli. Më pas kam kaluar si pjesë e dhomës penale. Më është thënë në atë kohë nga kryetari i gjykatës sepse me thënë të drejtën unë u stepa kur më tha që do të kalosh në dhomën penale sepse vija direkt nga shkolla dhe me idenë që penalja më dukej si me frikë. Po flas më shumë sinqeritet tani dhe ai më tha, e para më sfidoi, përderisa ke marrë përsipër të bësh detyrën e gjyqtares fjala frikë nuk duhet të ekzistojë në fjalorin tënd dhe e dyta më tha unë kam nevojë sepse ai po merrte një plan masash për të përmirësuar imazhin dhe besimin publik tek drejtësia penale në Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Fier. Nuk duhet të harrojmë që Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Fier ka pasur problematika të vetat që janë të lidhura me kontekstin shoqëror, pozicionin gjeografik dhe ka pasur çështje problematike, çështje problematike që për nga rangun i tyre ishin të shumëllojshme. Sigurisht që pjesa më e madhe e çështjeve kishin të bënin me gjykimin në themel të çështjeve, qoftë si gjyqtar i vetëm, qoftë dhe si gjyqtar në përbërje të trupit gjykues. Unë psh. kujtoj me shumë kënaqësi, ka qenë vendimi i parë që kemi dhënë në Republikën Shqipërisë për pastrimin e parave, pastrimin produkteve të veprës penale dhe ka qenë një çështje e ndjekur nga misioni OPDAT. Misioni OPDAT i SHBA vinin e ndiqnin në seancë gjyqësore që është shumë e vështirë mendoj unë për zhvillimet e kohës. Por sot mund të mos duket e vështirë dhe për moshën që unë kisha padyshim kam ndjerë e vështirësinë e pjekurisë jetësore në ushtrimin detyrës. Megjithatë mund të them se ambienti i punës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësorë Fier ka qenë pozitiv dhe krahasoja këtë dhe me përvojat e të ngjashmëve të mi në gjykata e tjera. Ishte një gjykatë që të nxiste për mendimin juridik. E dyta dua të them që përkundrajt asaj që besohet gjerësisht në publik dhe besoj që juve duke qenë profesioniste të thellë të ligjit ndoshta mund të ndani të njëjtin qëndrim me mua që çështjet nuk mund të ndahen tipikisht të vështira dhe të lehta. Madje është e habitshme ndonjëherë që çështja që duket shumë e thjeshtë në akuze, mund të ngrejë brenda çështje shumë të rëndësishme dhe kanë këtë avantazhin

që gjyqtari dhe prokurori bëhet edhe më me iniciative në ato lloj çështjesh të eksploroje interpretimin e ligjit për shkak të natyrës komplekse që mund të këtë një problem juridik të caktuar. Faleminderit.

Vitore Tusha merr fjalën dhe shprehet se ju në përshkrimin e motivacionit dhe me shkrim po ashtu keni prezantuar se keni bërë rreth 50 përfaqësime në Gjykatën Kushtetuese. Duke dashur paraprakisht tju vlerësoja dhe (*dy fjale nuk dëgjohen*), pavarësisht se jeni në këtë ambient, për cilësinë e përfaqësimit që keni bërë, e që ka qenë një nga përfaqësueset më të mira mendoj të institucioneve publike këto vite dhe këtë që them e meritoj, doja të dija nëse përfaqësimet tuaja, qëndrimet tuaja personale profesionale kanë qenë gjithmonë të përputhura me qëndrimin që keni mbajtur në gjykimet konkrete, në gjykimet ku ju keni qenë përfaqësuese? Ka pasur ndonjë diferencë në rastet kur ju keni qenë për mbrojtjen e institucioneve publike? Përfaqësuesit vijnë dhe prezantojnë institucionet, por e përfaqësojnë jo gjithmonë si dhet duke dashur të jenë gjithmonë në përputhje me interesin e institucionit. Në këtë kuptim desha të di cilësitë tuaja në raport me këtë proces.

Kandidatja Marsida Xhaferllari përgjigjet se të falënderoj për fjalet e mira dhe ju vlerësoj shumë. Unë kam filluar këtë proces në shkurt të vitit 2008 dhe kur mu kalua si detyrë në fakt me të thënë të drejtën kisha skepticizëm sepse vija nga një detyrë që thosha gjithmonë që e drejta është kështu dhe nuk besoja se si mund të bëhej. Nuk dija më saktë se nga shkolla kisha bërë direkt detyrën e gjyqtarës dhe nuk dija çdo të thotë të jesh palë. Të jesh palë që të mbrosh interesin e asaj palë që ti përfaqëson do të thotë ti një pozicionin që duhet të theksosh dhe ato anë të forta të çështjes që i shërbejnë interesit të palës. Vitin e parë të punës ka qenë një vit që unë kam marrë udhëzime dhe miratime të qëndrimeve pothuajse të shprehura, në kuptimin që mbasi vinte çështja, përgatisja dhe thoja që ka këto hapësira veprimi, janë këto çështje dhe ju lutem më miratoni nëse është në rregull kjo strategji mbrojtjeje. Më pas me thënë të drejtën në një fare mënyrë më është lënë dorë e lire. Dorë e lirë në kuptimin që unë kam ndjekur këtë lloj procedure. Por kur kanë qenë çështje sensitive padyshim që më kanë njoftuar se si do të jetë qasja. Mbaj mend, për të veçuar, psh. ka qenë një çështje më të përndjekurit, me ligjin e të përndjekurve politik, që shoqata e të përndjekurve politike e kontestoi në Gjykatën Kushtetuese. Ndoshta për shkak të përvojës, unë isha marrë me çështjen e dëmshpërblimit financiar të të përndjekurve politik dhe duke lexuar letrat e provat nga shteti shqiptar në vitin 45-50 kisha një lloj emocion për çështjen. Dhe mbaj mend që aty e kam pas shumë të vështirë pjesëmarrjen personale, në kuptimin që më mundonte dilema që këto janë shtrese e vuajtur, kanë vuajtur tërë jetën. Në dy tre çështje që ato kishin ngritur, unë në thelb besoja që kishin të drejtë, ndoshta mund të mos ishte në nivelin kushtetues i ngritur siç duhej në kërkesën e tyre, por kisha një lloj dilemë

morale dhe kam shkuar e kam kërkuar udhëzime dhe kam ardhur në atë gjyq, që e mbaj mend, me siklet dhe jam përpjekur që të ul nivelin e pasionit në mbrojtjen e çështjes, ndoshta edhe të modeloja gjuhën më shumë me argumenta teknike se sa me ato sociale të çështjes. Por mendoj që detyra e kërkon të jesh palë dhe do të forcosh pjesët e forta të argumentit. Sigurisht që kam besuar që bëja pjesë në një administratë që zbatonte ligjin, dmth. kjo ka qënë premisë kryesore edhe nëse ishte një ligj i shkruar keq, mendoja që ishte shkruar keq padashje. Faleminderit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani pasi vëren se nuk ka pyetje te tjera, orienton vijimin e intervistës, në pjesën e dytë të saj, lidhur me vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja. Ekspertja Dr. Adelina Albrahimi ftohet të marrë fjalën dhe të zhvillojë bisedën për aq sa ajo e vlerëson të arsyeshme lidhur me pjesën e njohurive të gjuhës se huaj.

Ekspertja Dr. Adelina Albrahimi zhvillon bisedën e lirë dhe me pyetje përgjigje me kandidaten Marsida Xhaferllari në gjuhën angleze (Intervista zgjati 5 minuta dhe 40 sekonda).

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani në përfundim të pjesës së intervistës në gjuhën angleze, e njofton kandidaten Regleta Panajoti për përfundimin e intervistës duke falënderuar jo vetëm për kryerjen e detyrimit për të prezantuar vizionin dhe për tu përgjigjur pyetjeve, por edhe për nga mënyra se si u prezantuat.

Kandidatja Marsida Xhaferllari shprehet se ju faleminderit edhe nga unë përzemërsisht dhe ju uroj suksese.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon anëtarët se ky ishte programi i intervistave të mbledhjes. Nuk mund të përcaktohet data e mbledhjes së ardhshme sepse jemi në proces pune. Por sigurisht mbledhja nuk mund të jetë pa u përfunduar procesi i shqyrtimit të dokumentacionit që kanë sjellë kandidatet dhe, mbasi të kemi ide të qartë, të lidhura edhe me disa projektakte vlerësimi apo projekt-raporte që duhet të përgatiten, atëherë do të thërrasim edhe mbledhjen.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani duke i falënderuar të gjithë për angazhimin dhe durimin sepse ishte mbledhje e gjatë, ndonëse Këshilli është mësuar të ketë shpesh mbledhje të gjata madje edhe 5 orëshe, deklaron mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 16.30

Sekretare
Dorina Dulaj
Ermelinda Kadiu
Redjona Myrtja

Kryetari
Ardian Dvorani